



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

# **Agjencia Kosovare e Privatizimit**

## **Raport Vjetor**

**2009**

## Përmbajtja

1. DEKLARATA E KRYETARIT .....	3
2. STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	5
2.2 AKTIVITETET E BORDIT GJATË VITIT 2009 .....	6
3. DIVIZIONI I REALIZIMIT TË ASETETEVE .....	8
3.1 DEPARTAMENTI I SHITJES.....	8
3.1.1 Njësia për përgatitjen e Tenderëve .....	11
3.1.2 Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor.....	12
3.1.3 Njësia Kadastrale.....	13
3.1.4 Njësia për Bujqësi dhe Pylltari .....	13
3.2 NJËSIA PËR SHYTP DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN.....	14
3.3 DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT .....	15
3.3.1 Njësia e Likuidimit.....	15
3.3.2 Njësia e Tranzicionit .....	16
3.3.3 Njësia për Mbylljen e Tenderëve.....	16
3.3.4 Njësia për Listat e Punëtorëve .....	17
4. DIVIZIONI PËR QEVERISJEN KORPORATIVE .....	22
4.1 NJËSIA KONTROLLUESE DHE MBIKËQYRËSE .....	22
4.2 NJËSIA E ADMINISTRIMIT DIREKT .....	23
4.3 NJËSIA E MONITORIMIT .....	25
4.4 NJËSIA E TREPÇËS.....	27
5. DEGA EKZEKUTIVE .....	31
5.1 DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM REGIONAL .....	31
5.2 NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM .....	32
5.3 DEPARTAMENTET E FINANCEVE DHE BUXHETIT .....	33
5.4 DEPARTAMENTI LIGJOR .....	35
5.4.1 Sekretariati i Bordit të Drejtoreve të AKP-së.....	35
5.4.2 Njësia e Ankesave.....	35
5.4.3 Komisioni për shqyrtimin e listave të punëtorëve .....	36
5.4.4 Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Likuidim (KSHAL) .....	36
5.5 DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE.....	37
5.6 DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS .....	40
SHTOJCAT .....	42
SHTOJÇË I – LIBRI AMZË INFORMATIV PËR KOMPANITË NËN ADMINISTRIM DIREKT .....	43
SHTOJÇË II – LIBRI AMZË INFORMATIV PËR NSH-TË E KOMERCIALIZUARA .....	50
SHTOJÇË III – LIBRI AMZË INFORMATIV PËR NSH-TË ME SPIN-OF SPECIAL .....	52
SHTOJÇË IV – BILANCI NË LLOGARITË BANKARE 2008-2009 .....	54
SHTOJÇË V – LLOGARITË VJETORE TË AKP-SË PËR 2008-2009 .....	56
SHTOJÇË VI – PËRMBLEDHJE E INFORMATAVE PËR MENAXHMENTIN .....	65

## 1. Deklarata e Kryetarit

I nderuari President dhe anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ne emër të Bordit të Drejtorëve, kam kënaqësinë t'ju informoj qe Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është plotësisht operationale dhe po shkon përpara drejtë arritjes së caqeve të veta në privatizimin e ndërmarrjeve të mbetura me fokus të veçantë ne N. SH-të e mëdha dhe strategjike për zhvillimin e ekonomisë së Republikës së Kosovës dhe të bëhet fuqi shtytëse në mbylljen e rasteve të likuidimit. Gjatë periudhës raportuese, ne i kemi kompletuar detyrat e dala nga biznes plani për vitin 2009.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 15 qershor 2008 (këtej e tutje "Ligji"). Ky ligj zbaton dispozitat përkatëse të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 Mars 2007 (Shtojca VII, Neni 2 prej saj), që është një pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Neni 145 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

Agjencia Kosovare e Privatizimit si një organ i pavarur publik që do ti kryej funksionet dhe përgjegjësitë e saj me autonomi të plotë. Agjencia duhet të posedoj individualitet të plotë juridik dhe në veçanti kapacitet për të hyrë në kontrata, të siguroj, të mbaj dhe të rregulloj pronën si dhe të ketë të gjitha kompetencat e përfshira për të shkarkuar plotësisht detyrat dhe kompetencat që i janë dhënë me ligjin aktual; dhe të padit dhe të paditet në emrin e vet.

Bazuar në nenin 20, pika 20.2 të Ligjit, Bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe do të bëjë publik një raport vjetor të Agjencisë i cili duhet të përfshijë:

- a) Pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë;
- b) Veçmas nga llogaritë e Agjencisë, pasqyrat financiare të llogarive dhe aseteve e cila mbahen nga Agjencia në mirëbesim;
- c) Listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë në pajtim me nenin 6.1;
- d) Listën e transaksioneve të kryera sipas nenit 8 të realizuara gjatë vitit për të cilin raportohet dhe për transaksionet e mbetura pezull;
- e) Listën e ndërmarrjeve të likuiduara sipas nenit 9; dhe
- f) Listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit.

Bordi i drejtorëve me anë të kësaj paraqet Raportin Vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për vitin kalendarik 2009 – një vit i suksesshëm për AKP-në duke pas parasysh situatën e trashëguar, ndikimin e krizës globale financiare dhe vështirësitë lidhur me Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës. Deri në përfundim të vitit AKP-ja ka tenderuar 85 N.SH në 98 Ndër. të Reja. Në total 102 kontrata të spin-ofeve të rregullta (përfshirë disa transaksione të mbetura pezull nga Agjencia paraprake (AKM) dhe 65 kontrata të shitjes së aseteve me likuidimit (nga AKM) janë nënshkruar dhe asetet përkatëse u janë dorëzuar pronarëve të rinj.

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

Veç kësaj 41 kontrata janë në përgatitje e sipër. Për me tepër AKP-ja ka arritur ti publikoj 27 lista përfundimtare të punëtorëve dhe 87 lista fillestare të punëtorëve (të gjitha të varura nga shqyrtimi dhe vendimi i OVGJS së Kosovës)

Bordi i Drejtorëve tashmë ka miratuar planin ambicioz të biznesit për vitin 2010 dhe ne do të përpiqemi të arrijmë dhe tejkalojmë detyrat që dalin nga ai dokument. Që nga fillimi i programit të likuidimit ka vendosur 120 N. SH në likuidim (të gjitha të trashëguara nga AKM) dhe gjatë vitit 2010 ne planifikojmë valën e pare të 55 rasteve të likuidimit.

Një përmbledhje e programit të privatizimit tregon se totali i të hyrave nga spin-ofet e paguara dhe të vendosura në bankë arrijnë shumën prej €429.8 milion, në krahasim me €387.6 milion të vitit të kaluar. Të hyrat totale të paguara apo të mbetura pezull janë €442.3 milion.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së vazhdon të takohet në baza të rregullta në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij me ligjin aktual. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për atë çfarë unë e konsideroj mjaft produktive dhe të suksesshme e që është kontributi i të gjithë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në Agjenci.

Unë gjithashtu dëshiroj të falënderoj donatorin e vetëm të Agjencisë ZKNE në Kosovë për përkrahjen e tyre të vazhdueshme.

Dhe në fund, dëshiroj që sinjerisht të shpreh mirënjohjen time për menaxhmentin dhe personelin e Agjencisë për përpjekjet e tyre enorme dhe përkushtimin pasi që ata mbeten e vetmja fuqi shtytëse që ka qëndruar pas Agjencisë gjatë këtyre 12 muajve.

Përfundimisht, ju lutem më lejoni t'ju siguroj që Agjencia mbetet në dispozicionin tuaj në çdo kohë për t'ju ofruar klarifikime shtesë në rast nevojë.

Bordi i Drejtorëve,

Dino Asanaj,  
Kryetar  
Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Shkurt, 2010

## 2. Struktura Organizative

Struktura organizative e AKP-së mund të ndahet në tri pjesë funksionale: Divizioni për Realizimin e Aseteve (RA) nën menaxhimin e Zëvendës Drejtorit Menaxhues, RA; Divizioni për Qeverisjen e Korporatave (QK) dhe Dega Ekzekutive nën mbikëqyrjen direkte të menaxhmentit të Agjencisë, përderisa Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Njësia për Shtyp dhe Marrëdhënie me Publik i raporton drejtpërdrejt menaxhmentit të Agjencisë në raste specifike Bordit të Drejtorëve.

Divizioni i Realizimit të Aseteve përmban dy departamente kryesore: Departamentin e Shitjes dhe Departamentin e Likuidimit.

Divizioni për Qeverisjen e Korporatave përmban Njësinë e Trepçës, Njësinë për Kontroll dhe Mbikëqyrje, Njësinë e Administrimit Direkt dhe Njësinë e Monitorimit.

Dega Ekzekutive përbëhet nga Zyrat Rajonale të udhëhequra nga Departamenti i Koordinimit Rajonal, Departamenti i Buxhetit dhe Financave, Departamenti Ligjor, Departamenti i Administratës dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore.

### **Drejtorët e Bordit të AKP-së gjatë vitit 2009 janë/ishin si në vijim:**

1. Dino Asanaj, Kryetar dhe Drejtor
2. Fadil Ferati, Zëvendës – Kryetar dhe Drejtor (1960 – 2010)
3. Andrea Capussela, Drejtor
4. Bahri Shabani, Drejtor
5. Haxhi Arifi, Drejtor
6. Hubert Eärsmann, Drejtor
7. Mohammed Omran, Drejtor
8. Slobodan Petrovic, Drejtor

### 2.2 Aktivitetet e Bordit gjatë vitit 2009

Bordi i Drejtorëve të AKP-së përbëhet nga tetë Drejtorë, pesë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si dhe tre anëtarët ndërkombëtar të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi themelimin e AKP-së. Bordi i ka të gjitha kompetencat e Agjencisë, i cili mund t'ia delegoj ushtrimin e kompetencave të veta menaxhmentit, përveç kompetencave të rezervuara për Bordin.

Në vijim është një përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të Bordit gjatë vitit 2009:

Më 21-22 janar 2009 mbledhja e shtatë (7) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur dhe në këtë mbledhje për herë të parë kanë marrë pjesë 2 anëtarët e emëruar së fundit nga përfaqësuesi i Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN). Bordi i AKP-së ka dhënë miratimin për fillimin dhe ri-themelimin e 120 Komisioneve të Likuidimit dhe gjithashtu ka miratuar transaksionet a valës 33 të privatizimit.

Mbledhja e tetë (8) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 27 dhe 28 shkurt 2009. Në këtë mbledhje është raportuar mbi situatën dhe çështjet e trashëguara nga ish Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) e cila në përgjithësi paraqet një barrë të jashtëzakonshme për dinamikën e punës së AKP-së në vitin 2009. Në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka aprovuar biznes planin për vitin 2009. Gjatë kësaj periudhe AKP-ja gjithashtu ka përpiluar një pasqyrë të strategjisë tre vjeçare të aktiviteteve dhe operacionale, të cilat i janë prezantuar Bordit të Drejtorëve.

Mbledhja e nëntë (9) e AKP-së është mbajtur me 26-27 mars 2009. Në këtë mbledhje të radhës vala e 34 e procesit të privatizimit është aprovuar. Në lidhje me këtë AKP-ja ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë më anë të së cilit procedurat lidhur me ndryshimet statusore të Ndërmarrjeve të shitura përmes spin-ofit special janë zyrtarizuar. AKP-ja më herët gjithashtu ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme lidhur me verifikimin/kontrollin e historikut lidhur me ofertuesit fitues (fituesit e përkohshëm) në procesin e privatizimit.

Mbledhja e dhjetë (10) e Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 29 prill 2009. Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka miratuar valën 35 të privatizimit në të vilën janë përfshirë 9 Ndër. të Reja dhe gjithashtu valën 36 në të vilën janë përfshirë 9 Ndër. të Reja. Në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve gjithashtu ka miratuar transaksionet e valës 33 të privatizimit.

Mbledhja e njëmbëdhjetë (11) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 29 maj 2009. Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka miratuar procedurat e Likuidimit dhe i ka azhurnuar format dhe është raportuar se një bazë e re e të dhënave është krijuar. Në këtë mbledhje, Bordi i Drejtorëve ka miratuar transaksionet e valës 34 të privatizimit dhe gjithashtu ka miratuar valën 37 në të cilën janë krijuar 10 Ndër. të Reja.

Mbledhja e dymbëdhjetë (12) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 26 qershor 2009. Bordi i Drejtorëve ka aprovuar Valën 38 të privatizimit me 12 Ndër. të Reja dhe valën

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

39 me 10 Ndër. të Reja. Për më tepër Bordi ka aprovuar pjesën më të madhe të transaksioneve nga Vala 35.

Mbledhja e trembëdhjetë (13) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 29 dhe 30 korrik 2009. Bordi i drejtorëve ka miratuar valën 40 të privatizimit me 9 Ndër. të Reja dhe valën 41 me 10 Ndër. të Reja. Për më tepër Bordi ka aprovuar pjesën më të madhe të transaksioneve nga Vala 36.

Në këtë mbledhje, Bordi i Drejtorëve ka aprovuar njëzëri propozimin për përputhje të plotë me marrëveshjet e zotimeve në lidhje me Ndër e Re Feronikeli, Birraria e Pejës dhe IMN Gjakova dhe për ti liruar ata nga detyrimi i raportimi i mëtutjeshëm në AKP. Menaxhmenti po ashtu ka raportuar se disa Ndërmarrje të mëdha do ti prezantohen Bordit të Drejtorëve për aprovim dhe si pasim të privatizohen.

Mbledhja e katërbëdhjetë (14) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 30 shtator dhe 1 tetor dhe janë miratuar për privatizim katër N. SH të mëdha, për tu përfshirë në valën të privatizimit. Në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve gjithashtu ka miratuar ritenderimin e Ndër. të Reja të kaluara në valën 41 të privatizimit, transaksionet e të cilave nuk janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve apo në rastet kur nuk ka pas oferta. Për më tepër Bordi ka aprovuar pjesën më të madhe të transaksioneve nga Vala 38.

Duhet të theksohet se në këtë mbledhje menaxhmenti i AKP-së ka raportuar se të gjitha procedurat për ushtrimin e “Kthimit të Aksioneve” lidhur me Ndër. e Re “Llamkos” janë përfunduar dhe se tani AKP-ja ka marrë nën kontroll objektet dhe e ka vendosur Ndër. e Re nën Administrim Direkt.

Mbledhja e pesëmbëdhjetë (15) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 30 tetor dhe kanë aprovuar pjesën më të madhe të transaksioneve nga Vala 39 të privatizimit. Në këtë mbledhje fillimi i valës 41 me Ndër. të Reja shtesë është miratuar ku janë përfshirë 32 Ndër. të Reja. .

Mbledhja e gjashtëmbëdhjetë (16) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 23 nëntor 2009 në të cilën janë miratuar transaksionet e valës 40.

Mbledhja e shtatëmbëdhjetë (17) e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është mbajtur me 16 dhjetor 2009, në të cilën janë miratuar transaksionet e valës 41. Bordi i Drejtorëve ka bërë një hap tejet të rëndësishëm lidhur me procesin e likuidimit duke miratuar versionin e rishikuar të Udhëzuesit të Likuidimit si dhe ka azhurnuar format.

### 3. Divizioni i Realizimit të Aseteve

Të gjitha aktivitetet e realizimit të asetëve të Agjencisë lidhur me ndërmarrjen nën autoritetin administrativ të saj bien mbi Zëvendës Drejtorin Menaxhues të Realizimit të Asetëve (AR). Dy departamente i raportojnë drejtpërsëdrejti ZDM të RA këto janë Departamenti i Shitjes dhe Departamenti i Likuidimit përderisa Departamenti i Koordinimit Rajonal i raporton ZDM RA vetëm mbi çështjet që kanë të bëjnë me përgatitjen e dokumentacion për privatizim dhe likuidim të ndërmarrjeve në rajonet përkatëse.

Në rast të privatizimit, duhet të jetë e qartë se AKP-ja ka tejkalar numrin e projektuar të Ndër. të Reja të planifikuara në Biznes Planin e vitit 2009. Në vitin 2009 AKP ka projektuar të përgatis 74 Ndër. të Reja sidoqoftë ka arritur të përgatis dhe tenderoj 98 Ndër. të Reja. Nga 98 Ndër. të Reja janë 16 Ndër. të Reja të cilat në Ditën e Hapjes së Ofertave nuk kanë pranuar asnjë ofertë. Prandaj AKP-ja ka arritur të tejkaloj planin nga 74 Ndër. të Reja deri në 98 Ndër. të Reja dhe dallimi është përgatitja e 24 Ndër. të Reja më shumë.

Nëse ne i shikojmë N. SH-të që AKP i ka planifikuar për 2009 të krijoj 74 Ndër. të Reja nga 47 N. SH, rezulton që AKP-ja ka arritur të krijoj 98 Ndër. të Reja nga 85 N. SH. Një numër prej 20 N. SH-ve është arritur për herë të parë nga privatizimi i vitit 2009. Kjo donë të thotë se nga 20 N.SH deri më tani asnjë Ndër. të Reja nuk janë krijuar nga këto N.SH.

#### 3.1 Departamenti i Shitjes

Departamenti i Shitjes përbëhet nga Njësia për Përgatitjen e Tenderëve, Njësia për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitor, Njësia Kadastrale dhe Njësia për Bujqësi dhe Pylltari.

Departamenti i Shitjes është përgjegjës për procesin e privatizimit dhe shitjet e likuidimit të N. SH-ve.

Vala 34,35,36,37,38,39,40 dhe 41 janë nisur në 2009 dhe një pjesë e madhe e këtyre transaksioneve pritet të përfundohen gjatë tremujorit të parë 2010 duke iu nënshtruar kontrollit të historikut.

Dita e Hapjes së Ofertave për valën 34 të Privatizimit është mbajtur me 20 maj 2009, që përmban 10 (10) N. SH në dhjetë (10) Ndër. të Reja. Numri total i ofertave të pranuar për spin of të rregullt ishte 39, me shumë totale prej € 7,958, 971.

Dita e Hapjes së Ofertave për valën 35 të privatizimit është mbajtur me 10 qershor 2009, duke përmbajtur nëntë (9) Ndër. të Reja. Numri Total i ofertave të pranuar për spin of të rregullt ishte 28, me shumë totale prej €2,301,810.

Dita e Hapjes së Ofertave për valën 36 të Privatizimit është mbajtur me 8 korrik 2009, duke përmbajtur shtatë (7) N. SH në nëntë (9) Ndër. të Reja. Numri total i ofertave të pranuar për spin of të rregullt ishte 34, me shumën totale prej € 3,010,825.



## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

Dita e Hapjes së Ofertave për valën 37 të Privatizimit është mbajtur me 12 gusht 2009, duke përmbytur nëntë (9) N. SH në nëntë (9) Ndër. të Reja. Numri total i ofertave të pranuar për spin of të rregullt ishte 34, me shumë totale prej € 6,200,756.

Dita e Hapjes së Ofertave për valën 38 të Privatizimit është mbajtur me 9 shtator 2009, duke përmbytur pesë (5) N. SH në dhjetë (10) Ndër. të Reja. Numri total i ofertave të pranuar për spin of të rregullt ishte 43, me shumë totale prej € 1,341,340.

Dita e Hapjes së Ofertave për valën 39 të Privatizimit është mbajtur me 14 tetor, duke përmbytur nëntë (9) N. SH në dhjetë (10) Ndër. të Reja. Numri total i ofertave të pranuar për spin of të rregullt ishte 27, me shumë totale prej € 2,319,215.

Dita e Hapjes së Ofertave për valën 40 të Privatizimit është mbajtur me 11 nëntor, duke përmbytur dymbëdhjetë (12) N. SH në dymbëdhjetë (12) Ndër. të Reja. Numri total i ofertave të pranuar për spin of të rregullt ishte 27, me shumë totale prej € 27,953,545.

Dita e Hapjes së Ofertave për valën 41<sup>st</sup> të Privatizimit është mbajtur me 9 dhjetor, duke përmbytur njëzetekatër (24) N. SH në njëzet nëntë (29) Ndër. të Reja. Numri total i ofertave të pranuar për spin of të rregullt ishte 82, me shumë totale prej € 7,966,890.

### **Përditësimi i pagesave**

Të gjithë fituesit e përkohshëm nga valët: 34 ,35 ,36 ,37 ,38 , kanë kompletuar (25%) të ratës së parë dhe (75%) të së dytës, vala 39 dhe 40 kanë kompletuar 25 % të pagesës bazuar në njoftimin e hollësive të pagesës të dërguara nga AKP dhe për valën 41 afati i fundit për pagesën e 25 % është 19 janari 2010.

### **Kontrollimet e historikut**

Pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit (MiM) në dhjetor 2008, në mes AKP-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), për ti kryer kontrollimet e historikut të ofertueseve fitues të përkohshëm në emër të AKP-së, lidhur me këtë gjatë vitit 2009 AKP-ja në vazhdimësi ka bashkëpunuar me Policinë e Kosovës – Drejtoratin për Analizën e Krimeve. Një total prej 110 rasteve i janë dërguar Policisë së Kosovës në mënyrë që të kryej kontrollin e historikut.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2009, tetë (8) valë të privatizimit janë përfunduar, në total nëntëdhjetë e tetë (98) Ndër. të Reja janë tenderuar. Ishin 334 ofertues, me një total të çmimeve të ofertave prej 59,053,353 €.

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

### Përmbledhje e spin off-it të zakonshëm të privatizimit deri me 31 Dhjetor 2009

2009 Aktivitetet Spin Off-et	Vala 34	Vala 35	Vala 36	Vala 37	Vala 38	Vala 39	Vala 40	Vala 41	Total
Si Ndër të Reja	10	9	9	9	10	10	12	29	98
Oferta të Pranuara Dita e Ofertimit	39	28	34	34	43	27	47	82	334
Dita e Ofertimit Totali Çmimit të ofertave/€	7,958,971	2,301,810	3,010,825	6,200,756	1,341,340	2,319,216	27,953,54 5	7,966,890	59,053,35 3
Tërheqjet Refuzimet/€	3,284,500	825,467	705,887	3,517,425	316,130	30,240	846,874	214,098	9,740,621
Totali i Çmimit të Ofertave/ €	4,674,471	1,476,343	2,304,938	2,683,331	1,025,210	2,288,976	27,106,67 1	7,752,792	49,312,73 2
Nr. I Ndër të Reja të refuzuara nga BiD, të tërhequra	4	4	3	4	3	3	4	13	38
Shitjet e përfunduara të Ndër të Reja	5	5	5	1	3	0	0	0	19
Shitjet e pa përfunduara të Ndër të Reja	1	0	1	4	4	7	8	16	41

Departamenti i Shitjes – Aktivitetet 2009
8 Valët
98 Ndër e Reja
14 Tenderët e anuluar për Ndër të Reja (vendim i bordit)
8 Tenderët e anuluar për Ndër të Reja (Tërhequra)
16 Ndër të Reja pa oferta
334 Numri i përgjithshëm i ofertuesve
200,000 Euro totali i depozitave të konfiskuara
59,053,353 Euro çmimi total i ofertave
18,013,390 Euro Totali pagesave (100 % i pagesave për Valët:34,35,36,37,38) (25% Vala 39 & 25% Vala 40 - 25% Vala 41 afati i fundit 19 Janar 10)

### 3.1.1 Njësia për përgatitjen e Tenderëve

Kjo njësi është përgjegjëse për mbikëqyrjen, koordinimin dhe menaxhimin e “mbarëvajtjes së privatizimit”, që nga faza e parë e shqyrtimit dhe përcaktimit të statusit, bazuar në dëshmi të dokumentuara historike, përmes shënimeve kadastrale dhe dokumenteve të tjera që një ndërmarrje më të vërtetë është në pronësi shoqërore, - që një NSH posedon tokë dhe asete të caktuar dhe në koordinim me NSH nga rajonet dhe industrinë e ndryshme duhet të ofrohet për shitje dhe për periudhën kohore të një tenderi të tillë duke marrë parasysh interesin e investitorëve të mundshëm.

Gjatë vitit kalendarik 2009 cak i Njesisë për Përgatitjen e Tenderëve ishte menaxhimi i mbarëvajtjes së privatizimit dhe përmirësimi dhe rishikimi i cilësisë dhe saktësisë së materialeve të privatizimit dhe të dhënave të përgatitura nga ZR dhe ZQ të AKP-së.

Në vijim janë disa detaje të aktiviteteve të realizuara dhe arritura në vitin 2009:

- Njësia ka qenë në gjendje që të koordinoj me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në lidhje me marrjen e informacionit dhe kontrollimin se 67 NSH të përgatitura për privatizim, nuk kanë asnjë pasuri të lënë peng dhe / ose të regjistruara në Zyrën për Regjistrimin e Pengut në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.
- Me 21 Janar 2009 kërkesa për bashkëpunim i është dërguar Gjykatës Ekonomike (GJE) Prishtinë, dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për shkak të miratimit dhe zbatimit të Urdhërësës Administrative Nr. 2008/02 që ka pasur ndikim në koordinimin në mes AKP-së dhe GJE.
- Kemi arritur të procedojmë 62 kërkesa për në Gjykatën Ekonomike për gjetjen e provave historike të dokumentuara që NSH në fakt janë pronë shoqërore
- Rishikimi i 61 KPS përcaktimin e statusit të ndërmarrjeve në emër të Departamentit të Shitjes, bazuar në prova historike të dokumentuara se ndërmarrja në fakt është pronë shoqërore.
- Janë shqyrtuar 85 formular aprovimi të Privatizimit (AP-së) në emër të Departamentit të Shitjes bazuar në dëshmitë historike të dokumentuara që një ndërmarrje në të vërtetë është pronë shoqërore, përmes shënimeve kadastrale dhe dokumenteve të tjera - që një NSH ka tokë dhe/ose asete të caktuara.
- Lista Kryesore Gjithpërfshirëse e NSH-ve është azhurnuar rregullisht

### 3.1.2 Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor

Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor siguron mbështetje të plotë për spin off-et dhe likuidimin për të gjitha shitjet e aseteve. Njësia e Marketing & MI mbështet Departamentin e Shitjes në publikimin e valëve të reja të Privatizimit dhe likuidimit, Shitjen e aseteve dhe çdo ngjarje tjetër që është me rëndësi për Agjencisë. Njësia punon ngushtë me të gjitha departamentet dhe njësitë e tjera brenda Agjencisë për të përfunduar me sukses procesin e privatizimit në Kosovë.

Njësia e Marketingut mbikëqyr prodhimin e një reklame televizive, një broshurë dhe katër publikimeve në gazeta për secilën valë të publikuar. Njësia e Marketingut ka prodhuar 8 incizime dokumentare për Ndër e Reja të privatizuar me sukses

Njësia e Marketingut i ka vendosur të gjitha informatat që kanë të bëjnë me Privatizimin në faqen e internetit të AKP-së. Kjo përfshinë publikimin e valëve të privatizimit, që të dy listat e punëtorëve ato të përkohshme dhe përfundimtare, Njoftimet për tender, Mundësi Punësimi, Komunikata për Shtyp, Rregulla dhe Rregullore, Lidhje të dobishme dhe informacione tjera të rëndësishme.

Njësia e Marketingut dhe MI:

- Jep informacione dhe material promovues investitorëve potencial. Po ashtu informon investitorët potencial ndërkombëtarë dhe promovon procesin e privatizimit, ne vend dhe ndërkombëtarisht.
- Ka nënshkruan marrëveshje të konfidencialitetit me të gjithë investitorët potencial të interesuar (mbi 7000) dhe u kane siguruar atyre të gjithë materialin e nevojshëm ( si p.sh rregullat e tenderit, memorandumit informues, fotografi etj).
- Janë siguruar se të gjithë investitorët potencial të jenë informuar me saktësi rreth procedurave të para kualifikimit dhe për mënyrën e drejtë të plotësimit të dokumenteve siç është e specifikuar në Rregullat e Tenderit.
- Të përmirësoj koordinimin ndërmjet Njesisë së Marketingut dhe departamenteve të tjera, në veçanti me Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun, në mënyrë që sa më mirë të përgatisë të gjitha materialet përkatëse për marketing/promovim të cilat do të mbështesin fuqishëm strategjinë për nxitjen dhe tërheqjen e investitorëve ndërkombëtarë, regjional dhe lokal.
- Organizon ekipe për udhëtime në terren për të forcuar mbledhjen e informacioneve për NSH të ndryshme dhe/ose për karakteristikat e çështjeve me interes të veçantë për Zyrat Rajonale dhe për të shoqëruar ekipin sipas nevojës.

### 3.1.3 Njësia Kadastrale

Njësia Kadastrale operon nën Departamentin e Shitjes të AKP-së dhe rolin e saj më i rëndësishëm ka qenë që të sigurojë që dokumentet kadastrale në dispozicion lidhur me pasuritë e patundshme, të cilat janë planifikuar që të ofrohen për privatizim nëpërmjet metodave zyrtare, të jenë të vlefshme.

Aktivitetet kryesore të njësisë kanë qenë:

- Ka shqyrtuar 85 AP (Aprovime për Privatizim) formular të ndërmarrjeve nëpërmes shënimeve dhe dokumenteve të tjera kadastrale që një NSH posedon tokë/asete të caktuara..
- Mesatarisht kemi bërë dy vizita në terren në mënyrë që të hulumtohen të gjitha problemet e mundshme rreth tokës dhe kërkesat nga palët e treta.
- Printimi i hartave tematike, për të mundësuar finalizimin e kontratave që u përkasin Ndërmarrjeve të reja të privatizuara. Kemi printuar 334 harta tematike.
- Është bërë zëvendësimi i dokumenteve kadastrale të vjetruara. Në mënyrë që të mundësohet finalizimi i kontratave që u përkasin ndërmarrjeve të reja, të privatizuara sipas legjislacionit aktual, dokumentet kadastrale duhet të sigurojnë të dhëna të reja.
- Kryesisht njësia është siguruar se të dhënat kadastrale mbi pronat e patundshme në Kosovë ishin të vlefshme. Kjo çështje është mjaft me rëndësi për shkak të faktit se Njësia për Bujqësi dhe Pylltari ka përgatitur disa prona të NSH-re për privatizim.

Në përgjithësi, është me rëndësi të përmendet se nga gjitha ndërmarrjet e reja të përmendura dhe përgatitura për privatizim, gjashtë prej tyre gjenden brenda territorit të komunës së Gjakovës dhe pjesa tjetër gjenden në territorin e komunës së Gllogovcit. Situata më problematike me të cilën jemi përballur sa i përket shënimeve kadastrale është hasur në Gjakovë.

Trajtimi i formës së parcelave të tokës nga zyrat lokale kadastrale që kanë qenë të përfshira në masën e komasacionit të tokave hulumtimet i ankesave të drejtuara nga palët e treta rezultojnë me shumë paqartësi për shkak të keqpërdorimit të dokumenteve kadastrale nga zyrat lokale kadastrale dhe gjykatat lokale.

Përveç problemeve të lartpërmendura, njësia ka bërë të gjitha përpjekjet për të përmirësuar bashkëpunimin me institucionet dhe autoritetet tjera Kosovare për të promovuar dhe mbrojtur politikat e AKP-së.

### 3.1.4 Njësia për Bujqësi dhe Pylltari

Që nga fillimi i vitit 2009 Njësia për Bujqësi dhe Pylltari ka qenë e përfshirë drejtpërdrejt në përgatitjen dhe finalizimin e 9 (nëntë) Ndër të Reja. Njësia për Bujqësi dhe Pylltari ka bashkëpunuar nga afër me ekspertët kadastral dhe me njësinë e marketingut në finalizimin e Ndërmarrjeve të Reja dhe po ashtu shoqërimin e investitorëve potencial gjatë vizitave në terren.

Aktivitetet kryesore të njësisë për Bujqësi dhe Pylltari kanë qenë:

- Koordinimi i veprimeve me Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe akterëve të tjerë në zgjidhjen e pengesa të mëdha për reformën e tokave në Kosovë ( të dhëna të pasakta/ose që mungojnë, konsolidimi, çështjet e qirasë për 99-vite, etj).

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

- Ka zgjedhur statutet e pa qarta juridiko/pronësore të kooperative bujqësore. Sektori i pylltarisë në bashkëpunim me zyrtaret e MAFRD ka implementuar Ligjin mbi Fermat Kooperativat dhe Pylltarinë.

### 3.2 Njësia për Shtyp dhe Marrëdhënie me Publikun

Njësia për shtyp dhe MP (Njësia për Sh & MP) ka për qëllim të ju shërbej të gjitha departamenteve brenda AKP-së, veçanërisht Divizionit për Realizimin e Aseteve, përkatësisht njësisë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë me objektivin e përgjithshëm të rritjes së fitimeve të AKP-së si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Gjatë vitit 2009, Njësia për shtyp dhe MP ka bashkëpunuar ngushtë me Departamentin e Shitjes së AKP-së, Zyrat Rajonale dhe Departamentin Ligjor për të gjeneruar informacion të saktë dhe në kohë të duhur për të informuar publikun e gjerë, palët e interesuara, investitorët potencial dhe audiencën e synuar për përbërjen e përgjithshme të privatizimit në Kosovë, dhe rreth NSH të caktuara në dispozicion për blerje.

Në përgjithësi në mbështetje të Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe përpjekjeve për privatizim, Njësia për Shtyp dhe Marrëdhënie me Publikun ka ndërmarrë këto veprime:

- Ka trajtuar një numër të madh pyetjesh të detajuara nga mediat – nganjëherë deri në katër në ditë, të arritura nga 9 gazeta ditore, 4 agjenci lajmesh, 3 radio stacione, dhe 3 stacione televizive kombëtare në Kosovë.
- Ka trajtuar një numër të madh pyetjesh të drejtuara nga mediat ndërkombëtare
- Ka marrë pjesë në disa emisione në Radio dhe Televizion.
- Ka organizuar, planifikuar dhe menaxhuar konferenca të shumta për shtyp në mbështetje të objektivave të AKP-së
- Ka bërë monitorimin e përditshëm të medieve ( nëntë gazetave dhe 3 Stacioneve Televizive), për tu siguruar se menaxhmenti i AKP-së dhe palët kyçe të interesit, vazhdimisht të janë të informuar rreth raportimit të medieve për Privatizim dhe çështje tjera relevante të AKP-së
- Ka hartuar dhe shpërndarë komunikata të shumta për shtyp për të mbajtur publikun e gjerë plotësisht të informuar për procesin e përgjithshëm të Privatizimit, dhe për të ruajtur standardet e nevojshme të transparencës dhe dhënies së përgjigjeve në pyetjet e drejtuara nga mediat.

## 3.3 Departamenti i Likuidimit

### 3.3.1 Njësia e Likuidimit

#### Komisionet e Likuidimit

Me themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) si trashëgimtare e AKM-së, AKP e ushtron mandatin e saj për likuidimin e Ndërmarrjeve në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-067 dhe Ligjeve përkatëse në fuqi dhe rregulloreve që mbulojnë dhe rregullojnë këtë proces shumë të ndërlikuar .

Ekzistojnë 120 Komisione të Likuidimit, tashmë të themeluara ( të gjitha të trashëguara nga Agjencia paraardhëse (AKM)). Secili komisioni i likuidimit duhet të ketë një anëtarë ndërkombëtar, i cili emërohet nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil (ICO) (paragrafi 9.2 Ligji mbi Themelimin e AKP-së). ICO fillimisht ka emëruar 20 anëtarë të komisioneve të likuidimit dhe ata tashmë janë të shpërndarë në Zyrat Rajonale përkatëse të AKP-së, dhe kanë filluar përgatitjet për Likuidime të mëtutjeshme dhe shitje të aseteve, shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave ka filluar, kompletimi i komisioneve të likuidimit pritet në fillim të janarit 2010. Më poshtë po paraqesim listën e komisioneve të likuidimit të AKP-së për 20 NSH me prioritet për përfundimin e likuidimit.

Nr	Emri i NSH	Rajoni/Komuna
1	Mirusha	Gjilan/Gjilan
2	Stacioni i Veterinarisë/	Gjilan/Ferizaj
3	Kinemaja e Qytetit/	Gjilan/Gjilan
4	Universiteti i Punëtorëve/	Gjilan/Ferizaj
5	Klinapremix	Pejë/Klinë
6	Fabrika e Farës/	Pejë/Klinë
7	Kompresori	Pejë/Gjakovë
8	Vrella-Teuta	Pejë/Istog
9	NBI Suhareka – Mbushja e pijeve jo alkoolike Suhareka (Emri i kaluar Schweppes) NBI Suahreka - NPJA Suhareka	Prizren/Suharekë
10	Ekoplast	Prizren/Rahovec
11	Termosistem	Prizren/Rahovec
12	Transporti	Prizren/Prizren
13	Kluz	Prishtinë/Drenas
14	19 Nëntori	Prishtinë/Drenas
15	Kosova Control	Prishtinë/Prishtinë
16	Teka Commerce	Prishtinë/Prishtinë
17	Shtypshkronja "Progresi"	Mitrovicë/Mitrovicë
18	DEN/DES	Mitrovicë/Mitrovicë
19	AC Vushtrri (Kooperativa Bujqësore)	Mitrovicë/Vushtrri
20	Teuta Bare	Mitrovicë/Mitrovicë

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

Gjatë mandatit të Agjencisë paraardhëse (AKM), nuk ka pasur procedura unike të likuidimit dhe udhëzime për t'i ndihmuar Komisionet e Likuidimit në kryerjen e detyrave të tyre ditore të cilat dalin nga ligjet e zbatueshme dhe politikat operationale të Agjencisë.

Për shkak të arsyeve të lartpërmendura Departamenti ligjor dhe ekspert nga Pohl Consulting & Associates ( në mbështetje të AKP) kanë azhurnuar formularët e likuidimit (Shabllon) dhe kanë hartuar Udhëzuesin për Likuidim për Komisionet e Likuidimit të AKP-së.

Për më tepër, nga përfaqësuesit e ICO janë bërë disa rekomandime për ndryshime në këtë udhëzues të Likuidimit dhe ato rekomandime janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të udhëzuesit me ndryshime. Rekomandimet e bëra nga përfaqësuesit e ICO-në lidhur me nevojën për ndryshimin e udhëzuesit për anëtarët e Komisioneve të Likuidimit të AKP-së janë analizuar nga stafi i Departamentit të likuidimit të AKP-së dhe nga Departamenti Ligjor. Dokument dhe formalët a azhurnuar kanë hyrë në fuqi më 01 Janar 2010 dhe të gjitha parakushtet për përfundimin e rasteve të likuidimit janë përmbushur.

### *c. Afatet Kohore të Likuidimit*

Ligjet dhe rregulloret të cilat e qeverisin likuidimin janë hulumtuar dhe janë hartuar hapat individual dhe afatet kohore. Tani është e qartë se një likuidim i cili përshkon të gjithë hapat e përcaktuar do të zgjasë, mesatarisht, 34 muaj për t'u përfunduar. Në fakt, harta e afateve kohore të likuidimit thekson se shumica e kohës së marrë (përafërsisht 19 muaj) është jashtë kontrollit të AKP-së

### *d. Baza e të Dhënave të Likuidimit*

Baza e të Dhënave të Likuidimit është përfunduar dhe tani është plotësisht funksionale. Ky i fundit është një aplikacion i bazuar në ueb, dhe i projektuar për të mundësuar, regjistrimin, përmirësimin dhe kërkimin e informatave për NSH në Likuidim dhe asetet e tyre.

### *e. Kursi për Praktikat e Falimentimit*

Njëzet e katër nga anëtarët e stafit të AKP-së nga ZR dhe ZQ e AKP-së kanë marrë pjesë në kursin "Praktika e Falimentimit". Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në dy module: Rimëkëmbja e Biznesit të Korporatave dhe Ligji dhe Procedurat e Falimentimit. Kursi tashmë ka përfunduar dhe provimi do të mbahet shumë shpejtë.

## 3.3.2 Njësia e Tranzicionit

Njësi e tranzicionit është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve lidhur me periudhën e tranzicionit. (Periudhën midis mbylljes së tenderit, dhe përgatitjen e ndërmarrjes për dorëzim tek blerësi i saj i ri dhe fillimin e likuidimit).

Gjatë vitit 2009 Njësia e tranzicionit ka arritur të procedoj 397, kontrata të nënshkruara për ofruesit e shërbimeve (195 në tranzicion dhe 202 në likuidim.) Këto janë kontrata të nënshkruara me ish punëtorët e NSH-ve për të përgatitur arkivat e NSH-ve të privatizuara dhe të punoj në përgatitjen e Listave të Punëtorëve për 20% dhe çështjeve tjera lidhur me fazën e Tranzicionit prej privatizimit në likuidim.

## 3.3.3 Njësia për Mbylljen e Tenderëve

Roli i Njesisë është për të përgatitur projekt-kontrata për shitjet e kryera nga AKP përmes metodës së spin-off-it dhe likuidimit. Pasi Bordi i Drejtorëve të miraton shitjen dhe Oferta është paguar plotësisht Njësia për Mbyllje të Tenderëve fillon përgatitjen e projekt-kontratës e cila



## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

përfshinë pronën e paluajtshme, asetet dhe detyrimeve dhe atë ia dërgon Departamentit Ligjor për shqyrtim ligjor.

AKP ka trashëguar nga Agjencia para ardhëse (AKM) 149 kontrata të mbetura pezull. Pas konsolidimit të Departamentit Ligjor të AKP-së në fillim të marsit 2009 dhe deri me tani janë përfunduar 102 kontrata të shitjes me spin-off (€39,272,858). Përveç kësaj janë përfunduar 65 kontrata të likuidimit në vlerë prej €12,975,053.

Tabela dhe grafiku me poshtë, në mënyrë të detajuar tregojnë të arriturat e AKP-së gjatë periudhës kohore që nga fillimi i marsit 2009, deri në përfundim të dhjetorit 2009

	Spin-off-i Zakonshëm		Spin-off Special		Likuidim	
	Në Numër	Në vlerë (€)	Në numër	Në vlerë (€)	Në numër	Në vlerë (€)
Kontratat e AKM-së të mbetura pezull	77	€ 34,478,440	2	€ 4,258,000	70	€ 14,189,134
Kontratat e nënshkruara nga AKP	106	€39,272,858	0	€ 0.00	65	€12,975,053

### 3.3.4 Njësia për Listat e Punëtorëve

Njësia për Listat e Punëtorëve mbetet e angazhuar për të shtyrë përpara procesin e shpërndarjes së 20% punëtorëve me të drejta legjitime.

AKP ka shpërndarë më shumë se 4.5 milion € tek 3065 punonjës të 19 NSH duke qar shumën e përgjithshme të shpërndarë deri me tani në 20.2 milion€.

Tabela më poshtë tregon shumën e 20% të shpërndarë tek secila NSH dhe numri i punonjësve që kanë përfituar nga shpërndarja e 20%

Nr	Emri i NSH	Regjioni	Shuma e shpërndarë	Nr. I Punëtorëve
1	IMN Dukagjini	Peja	€ 1,216,899.39	227
2	Fabrika e plastikës	Mitrovica	€ 185,335.61	142
3	FAN	Prishtina	€ 496,765.43	420
4	Eximkos	Prishtina	€ 605,156.20	110
5	Kosova Control	Prishtina	€ 17,476.67	6
6	Stacioni i Veterinarisë Prizren	Prizren	€ 32,573.39	5
7	Bujqësia Pejë	Peja	€ 258,513.50	115
8	Llapi	Prishtina	€ 39,541.02	123
9	Lux	Mitrovica	€ 87,790.36	438
10	IMB	Mitrovica	€ 28,403.61	182
11	Konfeksioni Trepça	Mitrovica	€ 11,221.34	46
12	1 Maj	Mitrovica	€ 14,682.72	160
13	17 Nëntori	Peja	€ 708,146.62	345
14	Auto House "Mustafe Rexhepi"	Gjilan	€ 40,592.69	262

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

Nr	Emri i NSH	Regjioni	Shuma e shpërndarë	Nr. I Punëtorëve
15	TE Rugova	Peja	€ 8,728.51	14
16	NHTT Rugova	Peja	€ 526,115.44	157
17	Çeliku	Gjilan	€ 169,598.98	171
18	NH Drita	Gjilan	€ 80,297.38	50
19	Kosova sirovina (lënda e parë)	Mitrovica	€ 35,810.29	92

Tabela 1: shpërndarja e 20% nga AKP - Lista e NSH-re

Është publikuar një numër total prej 114 listave të punonjësve ( 27 Lista Përfundimtare 87 Lista Fillestare) që nga marsi 2009

Në tabelën me poshtë janë paraqitur emrat e listave përfundimtare të publikuara.

Nr	Emri i NSH	Regjioni	Data Finale e publikimit të listës përfundimtare – Data e fundit	Afati i fundit për parashtrimin e ankesave në OVGJS	Nr. i punëtorëve në listë
1	KNI Ramiz Sadiku Prishtine	Prishtina	7-mars-09	27-mars-09	536
2	Ramiz Sadiku Prizren	Prizren	9-maj-09	30-maj-09	323
3	Ballkan	Prizren	9-maj-09	30-maj-09	1259
4	Krikos	Prishtina	9-maj-09	30-maj-09	14
5	Aromatik	Prizren	9-maj-09	30-maj-09	22
6	16 Qershori	Peja	9-maj-09	30-maj-09	16
7	Trasing	Prishtina	23-maj-09	13-qershor-09	242
8	Energomontimi	Prishtina	23-maj-09	13-qershor-09	48
9	Theranda	Prizren	23-maj-09	13-qershor-09	56
10	Fabrika e Kërpudhave	Prishtina	23-maj-09	13-qershor-09	25
11	Anamorava	Gjilan	23-maj-09	13-qershor-09	13
12	Fabrika e veglave dhe aparaturës	Gjilan	23-maj-09	13-qershor-09	229
13	Kosovatrans Gjilan	Gjilan	30-maj-09	20-qershor-09	158
14	Fabrika e Tullave Luboten	Gjilan	30-maj-09	20-qershor-09	4
15	28 Nëntori	Gjilan	13-qershor-09	4-korrik-09	255
16	Agromorava Viti	Gjilan	13-qershor-09	4-korrik-09	123
17	Kosovatrans Kamenica	Gjilan	13-qershor-09	4-korrik-09	42
18	Mustafa Goga	Gjilan	13-qershor-09	4-korrik-09	115
19	Çyçavica	Mitrovica	13-qershor-09	4-korrik-09	186
20	Stacioni Bujqësor Gjakova	Peja	13-qershor-09	4-korrik-09	4
21	Utva	Peja	13-qershor-09	4-korrik-09	179
22	Birraria e Pejës	Peja	11-korrik-09	01-gusht-09	508
23	Kosovarja	Prishtina	11-Korrik-09	01-gusht-09	138
24	Plantacioni Ferizaj	Gjilan	11-korrik-09	01-gusht-09	26
25	KHT Kosova	Prishtina	08-gusht-09	28-gusht-2009	692

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

Nr	Emri i NSH	Regjioni	Data Finale e publikimit të listës përfundimtare – Data e fundit	Afati i fundit për parashtrimin e ankesave në OVGJS	Nr. i punëtorëve në listë
26	Kosova Construction	Mitrovica	08-gusht-09	28-gusht-2009	252
27	Kosova Hidroteknika	Prishtina	08-gusht-09	28-gusht-2009	58

Tabela 2: Lista përfundimtare e publikuar

Nr	Emri i NSH	Rajoni	Publikimi i Listës (Data e Fundit )	Afati i fundit për parashtrimin e ankesave në AKP	Nr. i punëtorëve në listë
1	Bujqësia Prishtinë	Prishtina	09-maj-2009	30-maj-09	49
2	KB Orllani	Prishtina	09-maj-2009	30-maj-09	8
3	Fertrans Ferizaj	Gjilan	09-maj-2009	30-maj-09	13
4	KB Skivjani	Peja	09-maj-2009	30-maj-09	11
5	Universiteti i Punëtorëve	Gjilan	09-maj-2009	30-maj-09	3
6	Standard	Peja	16-maj-2009	8-qershor-09	111
7	KBI Agrokultura	Gjilan	16-maj-2009	8-qershor-09	255
8	Metalografika	Gjilan	16-maj-2009	8-qershor-09	11
9	Filigran	Prizren	16-maj-2009	8-qershor-09	44
10	Ferronikeli	Prishtina	06-qershor-2009	27-qershor-09	1866
11	Inginiering	Prishtina	06-qershor-2009	27-qershor-09	28
12	Jometalet Kaolini	Gjilan	04-korrik-2009	30-maj-09	11
13	KB Banja	Peja	04-korrik-2009	30-maj-09	3
14	KB Bujku-Rogana	Gjilan	04-korrik-2009	8-qershor-09	111
15	KB Vitia	Gjilan	04-korrik-2009	8-qershor-09	255
16	KB Mirusha	Gjilan	04-korrik-2009	8-qershor-09	11
17	Qëndresa/Morava-Kamenice	Gjilan	04-korrik-2009	8-qershor-09	44
18	Vetfarm-Viti	Gjilan	04-korrik-2009	27-qershor-09	1866
19	Teuta/Vrella	Peja	04-korrik-2009	27-qershor-09	28
20	AC Istog	Peja	18-korrik-2009	8-gusht-09	9
21	AC Kosova Lipjan	Prishtina	18-korrik-2009	8-gusht-09	47
22	Fabrika e Farave	Peja	18-korrik-2009	8-gusht-09	40
23	Drithnaja	Prishtina	18-korrik-2009	8-gusht-09	6
24	Pioniri	Gjilan	18-korrik-2009	8-gusht-09	178
25	SHAM Drita	Gjilan	18-korrik-2009	8-gusht-09	4
26	XIQ Karaqeve	Gjilan	18-korrik-2009	8-gusht-09	459
27	Malishgan	Peja	18-korrik-2009	8-gusht-09	95
28	Agimi - Mishi Gjakove	Peja	25-korrik-2009	15-gusht-09	70
29	Bentokos	Gjilan	25-korrik-2009	15-gusht-09	25
30	Dardania	Prishtina	25-korrik-2009	15-gusht-09	170
31	IMF Kosova-Industria e mishit F. Kosovë	Prishtina	25-korrik-2009	15-gusht-09	109
32	KB Ferizaj	Gjilan	25-korrik-2009	15-gusht-09	8
33	Mulliri Gjakove	Peja	25-korrik-2009	15-gusht-09	86
34	Qarkullimi/Promet	Gjilan	25-korrik-2009	15-gusht-09	68
35	Stacioni për mbrojtjen e bimëve	Peja	25-korrik-2009	15-gusht-09	5
36	Pasuria Bujqësore	Gjilan	25-korrik-2009	15-gusht-09	16

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

Nr	Emri i NSH	Rajoni	Publikimi i Listës (Data e Fundit )	Afati i fundit për parashtrimin e ankesave në AKP	Nr. i punëtorëve në listë
37	Tregtia e Kosovës	Prishtina	25-korrik-2009	15-gusht-09	12
38	Dobrusha	Peja	01-gusht-2009	21-gusht-09	9
39	Dubrava	Peja	01-gusht-2009	21-gusht-09	79
40	Dardania/Putnik	Prizren	01-gusht-2009	21-gusht-09	59
41	Hidromont	Peja	01-gusht-2009	21-gusht-09	11
42	Kosovashped	Prishtina	01-gusht-2009	21-gusht-09	36
43	Kosovatex	Prishtina	01-gusht-2009	21-gusht-09	386
44	Prizrencoop	Prizren	01-gusht-2009	21-gusht-09	15
45	Vet. Station Skenderaj	Mitrovica	01-gusht-2009	21-gusht-09	5
46	Elan	Mitrovica	15-gusht-2009	5-shtator-09	218
47	Artizanati	Prizren	15-gusht-2009	5-shtator-09	31
48	Banasa	Prizren	15-gusht-2009	5-shtator-09	10
49	1 Maj Rahovec	Prizren	15-gusht-2009	5-shtator-09	77
50	IFS Progresi	Prizren	15-gusht-2009	5-shtator-09	864
51	Klinapremix	Peja	15-gusht-2009	5-shtator-09	45
52	Thertorja Eksportuese Prizren	Prizren	15-gusht-2009	5-shtator-09	68
53	Vinex	Gjilan	15-gusht-2009	5-shtator-09	228
54	Integj	Gjilan	22-gusht-2009	12-shtator-09	786
55	Zastava Ramiz Sadiku	Peja	22-gusht-2009	12-shtator-09	993
56	Sek-Kos/Sirkos	Prishtina	22-gusht-2009	12-shtator-09	15
57	Fabrika e Pompave me Piston	Peja	22-gusht-2009	12-shtator-09	108
58	Kosovë Elektro/Eletrotehna	Prishtina	22-gusht-2009	12-shtator-09	18
59	Kombinati i Këpucëve dhe Lëkurës	Peja	29-gusht-2009	19-shtator-09	746
60	Fabrika e Armaturës	Peja	29-gusht-2009	19-shtator-09	57
61	Kulla/Ratko Mitrovicë	Prishtina	29-gusht-2009	19-shtator-09	21
62	Transporti	Prizren	29-gusht-2009	19-shtator-09	27
63	Prizren market	Prizren	29-gusht-2009	19-shtator-09	87
64	Bujku	Mitrovica	29-gusht-2009	19-shtator-09	24
65	Produkti	Mitrovica	29-gusht-2009	19-shtator-09	132
66	Komuna	Prizren	05-shtator-2009	25-shtator-09	765
67	Koritnik	Prizren	05-shtator-2009	25-shtator-09	50
68	Agroprodukti	Gjilan	05-shtator-2009	25-shtator-09	22
69	Grafikos	Gjilan	05-shtator-2009	25-shtator-09	56
70	Morava e Epërme	Gjilan	05-shtator-2009	25-shtator-09	68
71	Ndërtimtari	Prishtina	05-shtator-2009	25-shtator-09	33
72	Deçani	Peja	05-shtator-2009	25-shtator-09	23
73	Korenik	Peja	05-shtator-2009	25-shtator-09	104
74	KB Liria Bardhosh	Prishtina	12-shtator-2009	3-tetor-09	42
75	Modeli	Peja	12-shtator-2009	3-tetor-09	177
76	Bashkimi	Prizren	12-shtator-2009	3-tetor-09	7
77	NBI Suhareka	Prizren	12-shtator-2009	3-tetor-09	236
78	Kinemaja e Qytetit	Gjilan	12-shtator-2009	3-tetor-09	3
79	Kualiteti	Gjilan	12-shtator-2009	3-tetor-09	110
80	Vocar/Urata	Prishtina	12-shtator-2009	3-tetor-09	349
81	KB Drita Raushiq	Peja	19-shtator-2009	10-tetor-09	7

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009


Nr	Emri i NSH	Rajoni	Publikimi i Listës (Data e Fundit )	Afati i fundit për parashtrimin e ankesave në AKP	Nr. i punëtorëve në listë
82	Tregtia	Gjilan	19-shtator-2009	10-tetor-09	248
83	Ferma e Shpezëve Ereniku	Peja	19-shtator-2009	10-tetor-09	40
84	Fabrika e Ushqimit të Kafshëve	Prishtina	19-shtator-2009	10-tetor-09	17
85	Germia	Prishtina	26-shtator-2009	17-tetor-09	413
86	Fabrika për prodhimtarinë e Destinuar Zastava	Peja	26-shtator-2009	17-tetor-09	67
87	XIM Strezovci	Gjilan	26-shtator-2009	17-tetor-09	59

Tabela 3: Listat Paraprake të Publikuara

Që kur AKP ka marrë mbi vete Procesin e Privatizimit në Kosovë, një nga sfidat kryesore të agjencisë ishte që të përshpejtojë shpërndarjen e 20% tek punonjësit e kualifikueshëm

Me qëllim për të përmbushur një proces kaq të rëndësishëm AKP ka rritur kapacitetet e saj njerëzore dhe për këtë arsye ka ngritur një njësi të posaçme brenda Departamenti Ligjor, i cili do të merret vetëm me ankesat lidhur me 20%. Si rezultat i përpjekjeve dhe përkushtimeve nga ana e AKP-së, janë 114 lista të përkohshme dhe përfundimtare të publikuara gjatë vitit 2009.

Edhe pse ka pasur disa pengesa politike në lidhje me publikimin e Listës së Punëtorëve në gazetën Serbe, AKP ka mbetur këmbëngulëse në zotimet e saj dhe prandaj e ka zhbllokuar procesin përmes zgjidhjeve alternative. Avancimet janë mjaftë të dukshme – në mesatare 10 lista të punëtorëve janë publikuar për çdo muaj. Ky progres i veçantë paraqitet në diagramin në vijim.



Diagrami 3: Listat e Punëtorëve të Publikuara që nga Marsi 2009

Duhet të përmendet që AKP-ja nuk ka vazhduar të publikoj lista tjera të punëtorëve pasi që do të grumbullonte dokumente për Komisionin për Shqyrtim dhe DHPGJS.

## 4. Divizioni për Qeverisjen Korporative

Të gjitha aktivitetet e qeverisjes së korporatave të Agjencisë në lidhje me ndërmarrjet nën autoritetin administrativ mbesin me Zëvendës Drejtorin menaxhues për Qeverisjen e Korporatave (ZDM QK). Katër njësitë siç janë Njësia për Kontroll dhe për Mbikëqyrje, Njësia për Administrim të Drejtpërdrejtë, Njësia për Monitorim dhe Njësia për Trepçën i raportojnë drejtpërsëdrejti ZDM QK ndërsa Departamenti për Koordinim Regjional i raporton ZDM QK vetëm për çështjet që kanë të bëjnë me Qeverisjen e Korporatave të ndërmarrjeve në rajonet përkatëse. Sa i përket Trepçës dy drejtor menaxhues aktualisht janë me detyrë në Trepçë dhe një Zyrtar i ri mbi projektin e Trepçës do të punësohet gjatë tre mujorit të parë të vitit 2010 i cili do të ndërmarr aktivitetet raportuese dhe mbikëqyrëse.

### 4.1 Njësia Kontrolluese dhe Mbikëqyrëse

Detyrat kryesore të Njesisë kontrolluese dhe Mbikëqyrëse janë mbledhja dhe sistematizimi i raporteve financiare nga Ndërmarrjet Shoqërore (NSH) të cilat administrohen nga APK-ja. Sistematizimi, mbledhja dhe krahasimi i raporteve financiare me qëllim të mbrojtjes së vlerave të NSH-s, rritjen e vlerës apo edhe ndërmarrjen me kohë të masave në rastet kur prona mund të keq menaxhohet. Njësia për Kontroll dhe për Mbikëqyrje e ka përgatitur dhe e ka ekzekutuar transferimin e obligimeve nga NSH-ja tek Blerësit e atyre ndërmarrjeve sipas politikave operative të APK-s.

Përveç raporteve financiare të cilat janë mbledhur nga regjionet, kjo njësi i ka kryer po ashtu edhe aktivitetet e tjera si:

1. Ka kryer transferimin e obligimeve tek Blerësit për 126 Ndërmarrjet e Reja, ku Blerësit e Ndërmarrjeve të Reja janë informuar në detaje në lidhje me obligimet të cilat janë duke u transferuar tek ato dhe obligimi i tyre për të paguar borxhet. Prej 126 Ndër e Re, 63 prej tyre janë privatizuar nga AKM (prej 2005 deri 2008, 4 prej tyre janë prej vitit 2005, 2 prej tyre janë të vitit 2006, 20 prej tyre nga viti 2007 dhe 37 prej tyre janë nga viti 2008) dhe transferet e detyrimeve për këto janë kryer në vitin 2009 nga AKP-ja. 63 transfere të detyrimeve janë për Ndër e Reja që janë privatizuara nga AKP-ja.
2. Vizitat e bëra, takimet me Menaxhmentin dhe stafin tjetër për 58 NSH-t, ku ne kemi sugjeruar, informuar dhe pyetur ata që të koeporojnë me Zyrtarët tanë Regjional, jo vetëm për raportet financiare por po ashtu edhe për aktivitetet e tjera, dhe pas këtyre vizitave ne kemi parë përmirësimin e këtij kooperimi dhe administratorët e këtyre ndërmarrjeve me kohë dhe pa hezitim kanë ofruar të gjitha informacionet e kërkuara nga zyrtarët tanë.
3. Të gjitha njoftimet në lidhje me transferimin e obligimeve dhe të pronës iu janë dërguar ATK-së (Administratës Tatimore të Kosovës) dhe KEK-ut (Korporata Energjetike e Kosovës) janë për të njoftuar këto institucione për detyrimet që janë transferuar blerësve të ri, gjithashtu ATK-ja dhe KEK-u janë informuar që ato nuk kanë të drejtë të bëjnë kërkesë në komisionin e likuidimit për këtë përmbledhje që janë transferuar në Ndër e Re.

Forma tabelore me aktivitetet e sipër përmendura:

	Transferimi i obligimeve tek Ndër. Të Reja	Vizitat e bëra tek ndërmarrjet e ndryshme	Njoftimet dërguar TAK-ut	Njoftimet dërguar KEK-ut
Sasia	126	58	126	126

## 4.2 Njësia e Administrimit Direkt

Në rrjedhën e zakonshme të ngjarjeve, mbikëqyrja, kontrollimi dhe monitorimi i ndërmarrjeve është kryer nga Zyrat Rajonale të AKP-së. Në rastet kur një Ndërmarrje Shoqërore është dëmtuar financiarisht, kjo ka reflektuar në disfavor të interesit të ndërmarrjes dhe punëtorëve. Kur Zyrat Rajonale të AKP-së i kanë shterur mundësitë për të ndikuar në ato ndërmarrje që nuk kanë treguar sukses, atëherë propozohet që Administrimi Direkt të futet në ato ndërmarrje.

Sipas Ligjit nr. 03/L-067 neni 6.1, Njësia për Administrim Direkt e AKP-s është përgjegjëse për marrjen e kontrollit të drejtpërdrejt mbi një ndërmarrje me mendimit paraprak të Bordit të Drejtorëve.

Bazuar në aktivitetet dhe detyrat e Administrimit Direkt, të cilat janë kryer gjatë vitit 2009, ne mendojmë se rezultatet të cilat janë arritur nga Administrimi Direkt janë shumë të kënaqshme e të cilat do të prezantohen në vazhdim.

Duhet pas parasysh se Njësia e Administrimit Direkt ka një personel modest në numër nga gjithsej 5 persona: Udhëheqësi i Administrimit Direkt, 3 zyrtarë të Administrimit Direkt dhe një Jurist i cili i shërben edhe dy Njësive tjera të Qeverisjes Korporative.

Njësia e Administrimit Direkt është kompletuar me personel në datën 20 shkurt 2009 dhe nga atëherë vazhdon punën me kapacitet të plotë dhe me përkushtim.

### Ndërmarrjet që janë nën Administrim Direkt dhe arsytet për futjen e këtyre ndërmarrjeve në Administrim Direkt janë:

- Ndërmarrja Shoqërore “Emin Duraku” në Gjakovë.
  - Keq menaxhimi i kësaj ndërmarrjeje është shitja e aseteve të kësaj Ndërmarrje Shoqërore pa pëlqimin e Agjencisë.
- Ndërmarrja Shoqërore “Virxhinia” në Gjakovë.
  - Dokumentet e ofruara nuk paraqesin ndonjë dëshmi për të treguar se ndërmarrja është transformuar në Shoqëri Aksionare.
- Ndërmarrja Shoqërore “Rekreaturs” në Kamenovë, Mal i Zi.
  - Konflikt ligjor mbi pronën.
- Ndërmarrja Shoqërore “Unimont” Krushë e Vogël, Prizren.
  - Kredi për ABU (Agro Business Union) e papaguar më vlerë prej 1.1 milion dhe shitja e aseteve.
- Ndërmarrja Shoqërore “Sharr Salloniti” në Han të Elezit”
  - Parregullsi Financiare
- Ndërmarrja Shoqërore “Artizanati” në Prishtinë.
  - Mungesa e dokumentacioneve në lidhje me të drejtën e posedimit të ndërmarrjes.
- Ndërmarrja Shoqërore Qendra për Rini dhe Sport” në Prishtinë.
  - Konflikt i brendshëm dhe Detyrimet financiare

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

8. Ndërmarrja Shoqërore “DLB- Drejtoria , “Lavërtaria dhe Blegtaria” në Prizren.
  - Detyrimet financiare
9. Ndërmarrja Shoqërore “Nerezina” in Mushtisht, Prizren.
  - Mungesa e dokumentacioneve në lidhje me të drejtat e posedimit të ndërmarrjes
10. Ndërmarrja Shoqërore “Vreshtaria” në Landovicë, Prizren
  - Konflikte ligjore me ndërmarrjen Kosovavera.
11. Ndërmarrja Shoqërore “Ndër.e Re Llamkos” në Vushtrri.
  - Mospërmbushja e obligimeve të Spin-ofit Special nga Blerësi.

No	EMRI I NDËRMARRJES NËN ADMINISTRIMIN DIREKT	Data e hyrjes nën AD
1	NSH “EMIN DURAKU” Gjakovë (pasive)	09/04/2008 Bazuar në <u>AR1391</u>
2	NSH “VIRXHINIA” Gjakovë (pasive)	09/04/2008 Bazuar në <u>AR1367</u>
3	NSH "REKREATURS" Kamenovo-Mal i Zi (Zyra Ligjore e AKP-së është duke përcjellë procedurat ligjore)	20/03/2008 Bazuar në <u>AR1388</u>
4	NSH "UNIMONT" Krushë e Vogël, Prizren (pasive)	21/09/2006 Bazuar në <u>AR1091</u>
5	NSH "SARR SALLONITI" Hani i Elezit (është shitur në Valën e 40-t)	20/06/2006 Bazuar në <u>AR1002</u>
6	NSH "ARTIZANATI" Prishtinë (pasive- lëshuar me qira nga Ministria e Punëve të Brendshme)	20/06/2006 bazuar në <u>AR1015</u>
7	NSH "PALLATI I RINISË" Prishtinë (aktive)	24/05/2006 bazuar në <u>AR0998</u>
8	NSH "LAVERTARIA – BLEGTORIA" Prizren (ndërmarrje e vogël)	20/07/2006 Bazuar në <u>AR1020</u>
9	NSH "NEREZINA" Mushtisht, Suharekë (e tërë ndërmarrja është lëshuar me qira)	08/02/2006 Bazuar në <u>AR0853</u>
10	NSH “VRESHTARIA” Landovicë, Prizren (pasive)	14/07/2004 sipas kërkesës së ZR në Prizren e datës 30. 06. 2004
11	NSH "NDËR. E RE LLAMKOS” Vushtrri (pasive)	28/09/2009 Sipas mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të APK-s e mbajtur më 29 Prill 2009

Ndërmarrja e cila është vënë nën Administrimin Direkt gjatë vitit 2009 është:

1. “Ndër.eRe Llamkos” në Vushtrri
  - Mospërmbushja e obligimeve të Spin Off-it Special nga Blerësi.

**Ndërmarrjet të cilat janë hequr nga Administrimi Direkt gjatë vitit 2009 janë:**

1. Ndërmarrja Shoqërore “Therrtorja eksportuese” në Prizren.
2. Ndërmarrja Shoqërore “18 Nëntori”, Hoçë e Madhe në Prizren.

**Ndërmarrjet Shoqërore nën Administrimin Direkt të cilat janë privatizuar gjatë vitit 2009 janë:**

1. Ndërmarrja Shoqërore “Sharr Salloniti , në Han të Elezit.



## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

2. “Ferma e Kafshëve” në Arbanë (ish Dushanovë) të Prizrenit, e cila është një aset i ndërmarrjes Shoqërore “DLB – Drejtoria, “Lavërtaria dhe Blegtoria”.

Mund të nxirret si përfundim se Administrimi Direkt vazhdimisht e ka mbajtur një rol menaxhues në stabilizimin e gjendjes financiare e cila ka rezultuar në përmirësimin dhe parandalimin e shkatërrimit të mëtejme të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Detaje shtesë mbi aktivitetet dhe rezultatet e Administrimit Direkt për periudhën kohore 1 Janar-31 Dhjetor janë vënë në Shtojcën I.

### 4.3 Njësia e Monitorimit

Njësia e Monitorimit synon që të monitoroj përbushjen e kushteve që kanë të bëjnë me kontratat e komercializuara të nënshkruara në mes të UNMIK-ut dhe Departamentit për Tregti dhe Industri për ndërmarrjet që iu nënshtrohen komercializimit e po ashtu monitorimin e përbushjes së investimeve dhe zotimeve të punësimit, sipas Marrëveshjes së Zotimeve për ndërmarrjet e privatizuar përmes metodës së Spin Ofit Special.

#### Ndërmarrjet e Komercializuara

Komercializimi i parë është bërë më 13 Qershor 2000. Deri në vitin 2003 janë komercializuar 18 ndërmarrje, 9 prej tyre brenda afatit kohor për komercializim, 4 prej tyre janë privatizuar ndërsa 5 prej tyre janë ndërprerë nga komercializimi për arsye të mospërbushjes së zotimeve.

Njësia për Monitorim nuk ka trashëguar një pasqyrë të qartë dhe të saktë mbi përbushjet e kushtet e kontratave për komercializim nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Të gjitha të dhënat elektronike janë fshirë nga AKM-ja nuk ka mbajtur bazën e të dhënave për monitorimin e Ndërmarrjeve të Komercializuara, si në rastin e Spin Off-it Special. Përveç kësaj, raportet nuk janë azhurnuar dhe pothuaj të gjitha ndërmarrjet e raportuara vetëm deri në fund të 2007.

Për të kaluar na kjo situatë, auditorë të jashtëm të pavarur janë angazhuar nga AKP-ja për të gjitha ndërmarrjet e komercializuara. Të gjitha auditimet janë plotësuar, (përveç SharrCem e cila do t'i nënshtrohet procesit të auditimit gjatë vitit 2010), dhe nga raportet e auditimit rezulton një investim mesatar dhe përbushje e punësimit, ndërsa pagesa e qirasë mbetet nën kufirin mesatar.

Në anën tjetër janë 4 (katër) ndërmarrje të cilat kanë kërkuar për të hyrë në procesin e privatizimit para përfundimit të kontratës dhe të cilat planifikohet të privatizohen gjatë vitit 2010 e të cilat janë:

1. Zdrukthtaria,
2. Remont-Servis,
3. Industria Ushqimore dhe
4. Motel “Besiana”

Përveç kësaj, gjatë vitit 2010 ne do të vazhdojmë me privatizimin e fabrikën e SharrCem-it pa siç kontrata e komercializimit do të përfundoj më 13/06/2010.

#### Spin Off-et Speciale

Shitja e parë është bërë më 23 Mars 2005 përmes Spin Ofit Special dhe gjithsej janë privatizuar 24 ndërmarrje përmes Spin Of-it Special. Qysh prej fillimit të punës, AKP-ja ka nisur një auditim të jashtëm të pavarur për 22 ndërmarrjet e privatizuara përmes metodës së Spin O-fit Special.

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

Këto auditime janë plotësuar varësisht nga të dhënat e auditorit dhe duke u bazuar në strategjinë e Spin Ofit Special, Njësia e Monitorimit ka përgatitur rekomandime të veçanta për Bordin e Drejtorëve. Duke u bazuar në këto rekomandime, Bordi i Drejtorëve e ka miratuar lëshimin nga kushtet që rrjedhin nga Marrëveshja për Zotim, sipas nenit 7.1 të Spin Ofit Special, me sa vijon:

1. Banja e Kllokotit,
2. Feronikeli,
3. Birraria Peja
4. Industria e Materialit për ndërtim "IMN".

Ndërsa 6 (gjashtë) rekomandime pritet vendimi i Bordit të Drejtorëve, dhe ato janë:

1. Hotel Iliria
2. Rahoveci Birraria
3. Grand Hotel
4. IDGJ Duhani
5. MIM Golesh
6. XIM Strezoc

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur në Janar 2009 e ka konfirmuar vendimin e Bordit të AKP-s në mbledhjen e mbajtur në Maj 2008 në lidhje me Kthimin e Aksioneve për Llamkosin, pasi që Blerësi dhe Kompania e kanë shkëlur Marrëveshjen e Zotimeve.

Të gjitha procedurat janë plotësuar dhe aksionet janë kthyer në emër të N.SH-së në administrim të AKP-së.

Në anën tjetër janë bërë shumë përpjekje për të kaluar dhe për të shmangur gjendjen në ndërmarrjet të cilat kanë dështuar t'i përmbushin në tërësi zotimet dhe në rastet kur afati kohor sipas Marrëveshjes së Zotimeve ka kaluar. Gjatë vitit 2010 pritet të merren vendime për hapa të ardhshëm.

Për detaje të mëtutjeshme në lidhje me gjendjen e Ndërmarrjeve të Komercializuara dhe Ndërmarrjeve të Privatizuara përmes spin ofit special, shih shtojcën II dhe III:

### 4.4 Njësia e Trepçës

Raporti përfshin aktivitetet e përgjithshme punuese të ndërmarrjes Trepça, me theks të veçantë për minierat dhe flotacionin e ndërmarrjes, për vitin 2009. Në mënyrë analitike është paraqitur përmbushja e prodhimit për vitin 2009, për minierat Stantërg dhe Artana dhe Industria Kimike.

Si pasojë e qarkullimit negativ të tregut të aksioneve të metaleve dhe rënies drastike të çmimeve gjatë vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009 menaxhmenti i Trepçës e ka anuluar tenderin e shpallur për shitjen e koncentratit të Zinkut dhe të Plumbit në janar të vitit 2009. Me ngritjen e çmimeve në tregun e aksioneve të metaleve menaxhmenti ka vendosur ta rishpall tenderin për shitjen e koncentratit të Plumbit dhe të Zinkut. Aksioni i shitjes së koncentratit në Qershor i ka sjellë ndërmarrjes Trepça një ngritje të të hyrave me vlerë prej 548,796.28 € apo 57.76 % krahasuar me gjendjen e shitjes në muajin janar. Në raportin e prezantuar janë paraqitur vizitat e bëra në ndërmarrjen Trepça nga personalitetet e shquara vendase dhe ndërkombëtare.

#### Aktivitetet e ndërmarrjes Trepça

Trepça ka 9 (nëntë) miniera në Kosovë, 6 prej të cilave kanë mundësi të mira për aktivizim të plotë dhe biznes të suksesshëm. Këto miniera paraqesin një mundësi të shkëlqyer për eksploatimin e xehes. Ato gjinden në komunat e Albanikut (Leposaviç), Mitrovicë, Prishtinë dhe Artanë (NovoBërdo). Trepça ka dy shkretore të Zinkut dhe të Plumbit ndërsa si aktivitet sekondar ka fabrikën e baterive, fabrikën e plastikës, zbukurimet e argjendit, fabrika për municion të gjuetisë, fabrikën e procesimit dhe po ashtu hotelet dhe lokalet afariste.

#### Aktivitetet gjatë vitit 2009

Si vërejtje fillestare ne duhet ta theksojmë faktin se Trepça si një ndërmarrje përbëhet nga disa asete ku një pjesë e tyre gjendet në veri të Kosovës dhe ato akoma nuk janë kontrolluar tërësisht nga AKP-ja, ky raport përfshin aktivitetet e Trepçës vetëm për pjesën jugore. AKP-ja e ka caktuar një drejtor të ri për pjesën jugore të Trepçës dhe me ardhjen e tij puna ka filluar pa ndonjë vonesë në drejtim të identifikimit të problemeve të shumta me të cilat ballafaqohet ndërmarrja. Në Trepçë ka filluar riorganizimi dhe ristrukturimi. Struktura e re organizative është hartuar dhe duke u bazuar në të janë bërë ndryshime në kuadër. Qëllimi i vetëm për këto masa ka qenë rritja e produktivitetit të punës në Trepçë duke zbatuar metoda moderne të menaxhimit përmes planifikimit, organizimit, udhëheqjes dhe kontrollit. Menaxhmenti i Trepçës i ka përqendruar përpjekjet e saj në rritjen e stabilitetit financiar të ndërmarrjes duke bërë rritjen e të hyrave dhe duke zvogëluar humbjet.

Gjendja e tanishme në Trepçë (pjesën jugore) për sa i përket punëtorëve është si vijon:

Punëtorët e rregullt - 1339 të punësuar

Përfitues të pensioneve dhe stipendioneve - 3926 përfitues

- Me rekomandim të MLSË dhe të Zyrës së Auditorit të përgjithshëm, ata e kanë bërë identifikimin dhe largimin e 353 personave nga lista e përfituesve nga pensionimi i hershëm dhe asistencë sociale, ata kanë pasur kontratë pune por ata kanë përfitur po ashtu edhe pensionin e hershëm ose stipendio.

Përveç aktiviteve të tjera të përbashkëta të biznesit të kufizuar të Trepçës, më 20-28 Shkurt ata kanë organizuar manifestimin Java e Minatorëve, për të festuar përvjetorin e njëzetë të protestës së minatorëve. Ky manifestim është mbajtur për herë të parë nën përkujdesjen e Kryeministrit të Kosovës z. Hashim Thaçi. Gjatë kësaj periode, miniera e flotacionit në Stantërg, është vizituar nga politikanë, personalitete ushtarake dhe biznesmen si: Shefi i Zyrës Civile Ndërkombëtare

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

(ZCN) Peter Faith , Ambasadori i Francës në Prishtinë, z. Delphine Borione, Gjenerali i KFOR-it Francez z. Patrik Ribayrol, Komandanti gjeneral i trupave të KFOR-it në Kosovë E. Gay, përfaqësuesi i Ambasadës Amerikane dhe USAID-it, Ministria e Energjisë dhe Minierave znj. Justina Pula- Shiroka, Zëvendës Ministri për Ekonomi dhe Financa Bedri Hamza etj. Ata kanë biseduar dhe kanë shkëmbyer mendime me të gjithë këta personalitete me qëllim që të tejkalojnë vështirësitë dhe problemet që e preokupojnë minierën Trepça.

Gjatë këtij viti (2009), Trepça e ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Humboldt të Berlinit, Kolegjin universitar “Tempulli” në Prishtinë, Ministrinë për Shërbime Publike, Ministrinë e Energjisë dhe Minierave, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Posta dhe Telekomit i Kosovës.

Në të gjitha këto marrëveshje është planifikuar mundësia e bashkëpunimit, ndërsa brenda këtij bashkëpunimi Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor së bashku me Ministrinë e Energjisë dhe Minierave, me investim të përbashkët me ndërmarrjen Trepça për të ndërtuar objekteve të muzeut të kristaleve në Stantërg ku sipas projektit i cili tashmë është i gatshëm, këto objekte do të ndërtohen sipas standardeve Evropiane.

Bordi i Postës dhe Telekomit të Kosovës duke parë gjendjen e vështirë të Trepçës, vendosi që t'i dhuroj ndërmarrjes 80.000 Euro mjete monetare të cilat do të përdoren për përmirësimin e gjendjes së punës, ushqimit, riparimit të mensës dhe hapësirave të tjera të ndërmarrjes Trepça; zgjidhjen e borxhit të cilën kjo ndërmarrje e kishte me PTK-n me vlerë prej 14.736,37 Euro dhe një veturë e tipit Mercedes E-200. Marrëveshja në mes të palëve është nënshkruar më 03/06/2009 dhe zbatimi ka filluar menjëherë.

Me qëllimin për t'i integruar të gjitha asetet e ndërmarrjes Trepça, shumë takime dhe vizita janë realizuar në fabrikat si; Famipa në Prizren, fabrika e baterive industriale Trepça në Pejë dhe fabrika Metaliku në Gjakovë të cilat kanë treguar një mirëkuptim të plotë. Në fabrikën e fundit (Metaliku), një drejtor i ri është emëruar nga kryetari i komunës së Gjakovës z. Pal Lekaj, kjo tregon një tendencë pozitive për një bashkëpunim të mirë me Kuvendin Komunal. Po ashtu janë caktuar takime me menaxhmentin e ndërmarrjes Trepça në pjesën veriore. Menaxhmenti i pjesës jugore është takuar me drejtorin e pjesës veriore dhe ata janë marrë vesh që të thellojnë bashkëpunimin në fushat e interesit të përbashkët të kësaj ndërmarrje. Ky bashkëpunim po vazhdon në nivel të ekspertëve dhe stafit menaxhues të të dy anëve.

Në Maj, në minierën e Stantërgut, minatorët e kanë ndërprerë punën me qëllim të fillimit të grevës. Pa diskutimit shumë orësh në horizontin e tetë dhe pas konsultimit me kryeministrin e Republikës së Kosovës, është arritur një marrëveshje që minatorët të fillojnë punën ndërsa menaxhmenti së bashku me këshillin grevist e kanë formuar një komision në lidhje me pagesat duke nivelizuar dhe klasifikuar pozitat e punës në tërë ndërmarrjen, do të thotë puna e cila është kryer sipas këtyre kriterëve vijuese; kualifikimi profesional i punëtorëve, rreziku në vendin e punës, niveli i përgjegjësisë etj.

Komisioni e ka përfunduar punën me sukses dhe pagat për muajin Qershor janë dhënë në bazë të këtij klasifikimi. Gjatë kësaj kohe bisedimet kanë vazhduar me KEK-un dhe MEM –in në lidhje me borxhin e rrymës që e ka ndërmarrja jonë. Trepça i ka bërë kërkesë institucioneve përkatëse të Kosovës, t'i jap ndihmë buxhetore Trepçës, për ta tejkaluar situatën e vështirë të ndërmarrjes. Ekspertët e ndërmarrjes Trepça kanë marr pjesë në debate publike të organizuara nga Ministria e Energjisë dhe Minierave në lidhje me strategjinë e minierave dhe kanë shprehur idetë e tyre, këshillat dhe sugjerimet e tyre në lidhje me këto çështje.

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

Menaxhmenti i ndërmarrjes e ka hartuar një strategji për fillimin e proceseve të zhvillimit të ndërmarrjes Trepça, të cilat iu janë prezantuar të gjitha institucioneve përkatëse të cilat janë të lidhura me ndërmarrjen Trepça.

### Prodhimi, të hyrat dhe investimet kapitale

Në paragrafin vijues janë paraqitur prodhimi, të hyrat dhe investimet kapitale për vitin 2009. Këto shifra janë krahasuar me shifrat e vitit të mëparshëm me qëllim që të kemi një përshkrim më të mirë të arritjeve në vitin 2009.

### Prodhimi

Në miniera e Stantërgut janë prodhuar 27.73 % më shumë xehe sesa gjatë vitit 2008. Flotacioni në Tunelin e Parë gjatë vitit 2009 ka qenë 6.60 % më e lartë sesa vitin paraprak. Në anën tjetër prodhimi i xehes në minierën e Artanës ka qenë më e lartë në vitin 2009 për 45.19 % në krahasim me vitin 2008.

Gjithashtu, në flotacionin e Kishnicës ka pasur rritje prej 20.23 % të prodhimit se sa vitin paraprak.

Tabela vijuese paraqet të dhëna më specifike në lidhje me këtë çështje:

Emri i njësisë	Viti 2008	Viti 2009	Krahasimi 2008-2009 në %
Miniera në Stantërg	69,854.0 (t) Xehe	89,225.0 (t) Xehe	27.73%
Flotacioni në Tunelin e Parë	3,060.0 (t) K/Pb 5,207.0 (t) K/Zn	3,719.0 (t) K/Pb 5,094.0 (t) K/Zn	6.60%
Miniera e Artanës	19,777.0 (t) Xehe	28,713.0 (t) Xehe	45.19%
Flotacioni në Kishnicë	590.0 (t) K/Pb 1070.8 (t) K/Zn	620.0 (t) K/Pb 1,376.8 (t) K/Zn	20.23%

### Të hyrat

Në vijim, të hyrat tregojnë po ashtu një rritje. Të hyrat e pranuar nga prodhimi dhe procedimi janë paraqitur në tabelën vijuese.

Emri i Njësisë	Viti 2008 (€)	Viti 2009 (€)	Krahasimi 2008-2009 në %
Flotacioni në Tunelin e parë	2,529,822.10	4,321,055.17	70.80%
Flotacioni në Kishnicë	459,079.22	761,983.26	65.98%
Metalurgjia e Zinkut	0.00	1,275,264.56	
Industria Kimike	161,813.67	162,007.89	0.12%
Terminali Doganor	658,401.00	1,077,798.00	63.70%
GJITHSEJ	3,809,115.99	7,598,108.88	

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

### Investimet kapitale

Investimet kapitale të Trepçës në Sektorin e Minerës tregojnë shumën prej 2,301,400.00 €, kryesisht në mirëmbajtjen dhe përgatitjen e minierës për nxjerrjen e xehes. Në anën tjetër investimet në sektorin e industrisë dhe procedimit gjatë vitit 2009 ishte 252,495.00 €. Investimet e përgjithshme të realizuara për vitin 2009 arrijnë shumën prej 2,553,895.00 €. Shih tabelën vijuese:

Sektori	Emri i njësisë	Viti 2009
Sektori i minierave	Miniera në Stantërg	€2,301,400.00
	Flotacioni në Tunelin e Parë	
	Miniera në Artanë	
	Flotacioni në Kishnicë	
Sektori për Industri dhe Procesim	Metalurgjia e zinkut	€252,495.00
	Industria kimike	
	Fabrika e procesimit të pajisjeve	
	Terminali i doganës	
GJITHSEJ		€2,553,895.00

### Ndihmat e dhëna ndërmarrjes Trepça gjatë vitit 2009

Ndërmarrja Trepça, nën administrimin e AKP-s, gjatë vitit 2009 ka përfituar 4,739,431.00 € nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës në formë të ndihmës.

Këto ndihma financiare janë pranuar përmes transferove si në vijim:

- Pjesa e parë me shumë prej 1,443,527.00 € është transferuar në llogari të Trepçës më 11/02/2009.
- Pjesa e dytë me shumë prej 943,527.00 € dhe 150,000.00 € janë transferuar në llogari të Trepçës më 29/04/2009.
- Pjesa e tretë me shumë prej 423,536.00 € është transferuar në llogari të Trepçës më 30/07/2009.
- Pjesa e katërt me shumë prej 1,778,841.00 € është transferuar në llogari të Trepçës më 30/10/2009.

Nga këto ndihma financiare, 1,446,077.00 € iu janë dedikuar ndërmarrjes Trepça në pjesën veriore, ndërsa pjesa tjetër me shumë prej 3,293,354.00 € për ndërmarrjen Trepça në pjesën jugore.

## 5. Dega Ekzekutive

### 5.1 Departamenti për Koordinim Regjional

Departamenti për Koordinim Regjional mbikëqyrë punën e Zyrave Rajonale të AKP-s. Përveç Shtabit kryesor regjional në Prishtinë, AKP-ja ka pesë Zyra Rajonale (ZR) në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë me vendndodhje në tërë Kosovën dhe me tri zyra përkrahëse në Leposavic, Shtërpcë dhe Graçanicë të cilat mbajnë përgjegjësi primare në mbledhjen e informacioneve mbi NSH-t në rajonet përkatëse e po ashtu në implementimin e privatizimit, likuidimit dhe aktivitetet e qeverisjes së korporatave.

Mandati i Zyrave Rajonale është që të ushtrojnë funksionet administrative të AKP-s për NSH-të duke garantuar që AKP-ja është duke i kryer në mënyrë të duhur obligimet e besuara në lidhje me to. Zyrat Rajonale janë përgjegjëse për të përmbushur të gjitha detyrat që nevojiten nga AKP-ja që në mënyrë të suksesshme t'i kryej detyrat e saj të cilat nuk iu janë rezervuar ekskluzivisht nga Shtabi Regjional i AKP-s apo të caktuara nga njësitë tjera funksionale të AKP-s. Në veçanti, Zyrat Rajonale ndërmarrin likuidimin e ndërmarrjeve nën kompetencën administrative të AKP-s dhe si të tilla ofrojnë shumicën, nëse jo të gjithë stafin e Komisioneve për Likuidim.

Departamenti për Koordinim Regjional koordinon aktivitetet rajonale, duke siguruar një politikë të barabartë dhe implementim efektiv të vendimeve të AKP-s në tërë rajonin. Ajo po ashtu mbikëqyrë rrjedhën e informatave nga Zyrat Rajonale tek Departamentet dhe Njësit përkatëse të AKP-së.

Departamentet për Koordinim Regjional përmes pesë zyrave të saja rajonale gjatë vitit 2009 kanë qenë përgjegjëse për çështjet vijuese:

- Është krijuar Grupin punues (Task Force) për rishikimin e statusit të ndërmarrjeve të Gjakovës. Ky grup përbëhet nga Zyra Rajonale në Pejë, Departamenti ligjor, Departamenti Shitjeve dhe Njësia për Auditim të Brendshëm;
- Përgatitja e Listës së Përgjithshme për të gjitha NSH-të e AKP-së.
- Mbledhja e të dhënave përkatëse për NSH-të duke siguruar ruajtjen dhe sigurimin e saj.
- Identifikimi, analizimi dhe vënia në prioritet e NSH-ve për privatizim dhe duke ndihmuar aty ku është e nevojshme në lidhje me ato ndërmarrje të cilat vijnë nga sektorë të ndryshëm të AKP-s ashtu siç kërkohet brenda burimeve të kufizuara që janë në dispozicion;
- Përgatitja e tërë dokumentacionit për 8 (tetë) Valët e Privatizimit gjatë vitit 2009 e cila përfshinë 91 Ndërmarrje të Reja, 75 Informata për Bordin (IB), 91 Të dhënat mbi ndërmarrjen (LDH), 91 Memorandume informative (MI), 91 Rreziqe Përkatëse Ligjore dhe tjera (RPLT), 91 Zyra e të Dhënave (ZDH).
- Përgatitja e të gjitha dokumentacioneve për Kërkesa për Përcaktimin e Statusit (KPS- SDR) për 62 Ndërmarrje Shoqërore;
- 52 Lista të punëtorëve të përgatitura dhe të parashtruara Shtabit Regjional të AKP-s.
- Zyrat Rajonale kanë vërtetuar të gjitha informatat dhe azhurnimet Kadastrale, hipotekat, pengjet, 103 Kontrata nga shitja me Spin Of të zakonshëm dhe 65 kontrata nga shitja e asetëve nga Likuidimi.
- Çështjet financiare; monitorimi i rregullt dhe kontrolli i pasqyrave financiare të NSH-ve aktive.
- Çështjet ligjore: monitorimi i rregullt, ndihma dhe paraqitja ligjore e NSH-ve në gjykatat e rregullta kurdo që kërkohet.

- Çështjet kadastrale: Hetimi dhe plotësimi i të gjitha çështjeve ligjore të kërkuara Kadastrale të pazgjidhura dhe ngritja e kooperimit me Zyrat Kadastrale Komunale.
- Puna e vazhdueshme në skanimin dhe arkivimin e dokumentacioneve të NSH-ve në të pesë Zyrat Regjionale.
- Pjesëmarrja e anëtarëve të stafit të me vendndodhje në Zyrat Rajonale në trajnime brenda organizatës që kanë të bëjnë me procedurat e likuidimit.
- Të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me Valën 42 të privatizimit janë përgatitur dhe dërguar Shtabit Qendror të AKP-s.
- Departamenti për Koordinim Regjional përmes 5 (pesë) Zyrave Rajonale e ka identifikuar dhe përgatitur Planin e Biznesit për vitin 2010.

### 5.2 Njësia e Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm në mënyrë të suksesshme ka arritur të përmbush planin e saj të punës për vitin 2009, duke ofruar rekomandime substanciale menaxhmentit të lart.

Arritjet e paraqitura për vitin 2009 ndaras, për secilin aktivitet/auditim të ndërmarrë nga Njësia e Brendshme për Auditim.

1. **Auditimit i Departamentit të Burimeve Njerëzore**, Ky auditim ka filluar të funksionoj në shtator 2009, dhe kryesisht ka përfshirë auditimin e procedurave të rekrutimit, kontratat e punës, vlerësimet, përfundimet e kontratave, etj. Rezultatet që dalin nga auditimi, janë përbërë prej 6 (gjashtë) rekomandimeve përkatëse, të cilat gati të gjitha janë pranuar nga menaxhmenti. Përcjellja e rekomandimeve do të bëhet gjatë vitit 2010
2. **Auditimi i Njesisë së Prokurimit**, ka qenë pjesë e planit vjetor për vitin 2009 dhe është zhvilluar në pajtim të plotë me legjislacionin. Ky auditim kryesisht ka përfshirë procedurat e prokurimit dhe ka rezultuar me rekomandime konkrete që do të ndihmojnë menaxhmentin në të ardhmen. Përcjellja e rekomandimeve do të bëhet gjatë vitit 2010.
3. **Auditimet e bëra me kërkesë të menaxhmentit**, gjatë vitit 2009, janë kryer dy auditime të natyrave të ndryshme, avancimet dhe NSH “Amortizatorët”. Rekomandimet përkatëse janë dhënë për problemin e njëjtë.
4. **Hartimi i Strategjisë së NJAB-it për 2010 – 2012**, për herë të parë, është zhvilluar plani strategjik i auditimit të brendshëm në mënyrë profesionale, bazuar në vlerësimin e rrezikut për të gjitha Njësitë e AKP-së. Synimi i kësaj strategjie është përfundimi i procesit të auditimit për tërë sistemin (mbi 25 procese) brenda periudhës së tri viteve.
5. **Hartimi i Planit të punës për 2010**, është kryer në pajtim të plotë me strategjinë e NJAB-it, ku janë planifikuar 12 auditime të rregullta, monitorimi i rekomandimeve të ofruara gjatë vitit 2008, dhe auditimet me kërkesë të drejtorit. Të dyja dokumentet (planet e punës) janë miratuar nga Drejtorët e Bordit të AKP-së, dhe si të tillë ata kanë kompetencë ekzekutive në organizatë.
6. **Hartimi i Statutit të NJAB-it**, pas një pune mjaft të suksesshme, NJAB gjithashtu ka arritur të përgatis Statutin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në AKP. Në këtë dokument mjaft të rëndësishëm janë paraparë të drejtat dhe përgjegjësitë për auditorët e brendshëm, dhe menaxhmentin e lartë.
7. **Punët tjera**, të bëra në lidhje me punën menaxhimin dhe këshillimin për Menaxhmentin dhe të ngjashëm.



### 5.3 Departamentet e Financave dhe Buxhetit

Detyrat në vijim janë kryer suksesshëm nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit gjatë vitit 2009:

- Përfundimi i pasqyrës financiare për vitin fiskal 2008;
- Përgatitja e softuerit për vitin fiskal 2009 (fondet në mirëbesim, fondet e BKK-së, fondet e donatorëve dhe baza e të dhënave të listës së pagave)).
- Harmonizimet e rregullta mujore të llogarive në mirëbesim, buxheti i BKK-së dhe fondet e pranuar nga donatori;
- Raportet mujore janë paraqitur rregullisht Menaxhmentit të Agjencisë dhe Drejtorëve të Agjencisë;
- Raportet mujore janë paraqitur rregullisht Drejtorit të Thesarit në MEF;
- Harmonizimi vjetor i llogarive në mirëbesim, buxheti i BKK-së dhe fondet e dhuruara për vitin 2009;
- Përgatitjet mujore të Përmbledhjes së Sistemit Informues të Menaxhmentit (PSIM) dhe raportimi i rregullt tek Menaxhmenti;
- Çështja e interpretimit të ndryshimit të TVSH-së nga 15% 16% për kontratat në fuqi prej 1 janar 2009 është pajtuar në pajtueshmëri të plotë me Administratën Tatimore të Kosovës. Konfirmimi me shkrim është marrë nga ATK-ja për këtë interpretim;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka përfunduar fazën e parë të dizajnit bazës së të dhënave të avancuara në MS Eksel për administrimin financiar të fondeve në mirëbesim. Baza e të dhënave është testuar gjatë procesit të harmonizimit për muajt prej maj deri në dhjetor 2009. Faza e dytë e përcaktimit të bazës së të dhënave pritet të filloj në vitin 2010. Kjo fazë përfshinë dizajnimin e bazës së të dhënave në Access dhe integrim me bazën e të dhënave të Bankës Qendrore. Integrimi i raporteve të Sistemit të Menaxhimit të Likuidimit në AKP (SML) i Agjencisë dhe Departamenti i Financave dhe Buxhetit për të gjitha llogaritë bankare është gjeneruar suksesshëm në bazën e të dhënave të reja;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka përgatitur në platformën MS Eksel një Sistem të Menaxhimit të Likuidimit të avancuar për NSH-të në likuidim:
  - Baza e të dhënave është dizajnuar duke ju përmbajtur udhëzimet për dhënien e prioriteteve të ankesave ligjore, standardeve ndërkombëtare për likuidim dhe nevojave të Agjencisë për raportim nga komisionet e likuidimit dhe kërkesave për raportim të Financave dhe Buxhetit të AKP-së;
  - Bazuar në kërkesat e mësipërme, baza e re e të dhënave (LMS) është dizajnuar nga kontraktuesi i Agjencisë për aplikacionin e softuerit të integruar për të gjitha NSH-të në likuidim.
  - Softueri i ri mban formatin e raportimit si të përvijuar në bazën e të dhënave të kërkesave financiare dhe të likuidimit. Pranimi i fundit i certifikatës është nënshkruar. Softueri i ri do të përdoret nga të gjitha Komisionet e Likuidimit.
- Memorandumi për Mirëkuptim ndërmjet Bankës Qendrore të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare për Privatizim për transferet elektronike është nënshkruar më 12 dhjetor 2009. Objektiva kryesore e Agjencisë është regjistrim automatik dhe elektronik i transfereve bankare të përgatitur nga Agjencia dhe ekzekutuar nga BQK-ja.
- Buxheti për vitin 2010 për Agjencinë është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

- Pasqyrat Financiare për vitin 2009 janë përgatitur bazuar në Udhëzimet Administrative nga MEF-i dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP)
- Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim janë përgatitur në pajtim me konceptin e parasë së gatshme dhe sipas praktikës më të mirë. Ky format i pasqyrës financiare është audituar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në Kosovë gjatë vitit 2007 dhe nuk ka pasur ndonjë ankesë në format të raportimit financiar dhe është dhënë mendimi i pakualifikuar për auditim nga Auditori lidhur me pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

Gjatë vitit 2009, Agjencia ka pese auditime të jashtme:

1. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në Kosovë ka kryer auditimin e Pasqyrës Financiare për vitin 2008. Raporti i fundit të auditimit është lëshuar më 27 korrik 2009. ZAP ka lëshuar mendimin e pakualifikuar si në vijim: Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare paraqesin pasqyrë të drejtë dhe të vërtetë në aspektet materiale financiare të Agjencisë për periudhën që ka mbaruar më 31 dhjetor 2008 dhe operimet financiare gjatë vitit të njëjtë. Si theks i çështjes, ZAP-ja ka tërhequr vëmendjen Agjencisë për mungesë të raportimit nga pjesa e veriut të kompleksit Trepça.
2. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në Kosovë gjatë vitit 2007 ka audituar fondet në mirëbesim për periudhën prej korrik 2003 deri 30 shtator 2007 gjatë mandatit të ish Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Si vazhdimësi e auditimit të fondeve në mirëbesim, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në Kosovë ka kryer auditimin e fondeve në mirëbesim për periudhën prej 1 tetor 2007 deri 31 dhjetor 2009. Auditimit është performuar në dy faza. Faza e parë përfshinë periudhën prej 1 tetor 2007 deri më 30 shtator 2009. Ndërsa në fazën dytë përfshinë tre muajt e fundit të 2009 dhe auditimin e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim.
3. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në Kosovë ka kryer auditimin e vitit fiskal 2009. Auditimi është kryer në dy faza. Faza e parë përfshinë nën muajt e parë të vitit 2009. Ndërsa faza e dytë përfshinë tre muajt e fundit 2009, pasqyra financiare 2009 dhe regjistri i aseteve për 2009.
4. Auditimi i Grantit të parë të dhuruar (Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë) për periudhën gusht 2008 deri qershor 2009 është kryer nga Moore dhe Stephens Kontabilistët e Cerfitikuar nga Londra (kontraktuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Prishtinë). Ky auditim është kryer si auditim i rregullt i bërë në projekte të ndryshme të financuar nga ZNKE-së në Kosovë. Raporti i auditimit nuk është paraqitur akoma deri në datën e deklarimit të pasqyrës financiare të Agjencisë për vitin 2009, dhe
5. Auditimi i grantit të parë të dhuruar (ZNKE) është kryer nga Univerzum Audit nga Prishtina (kontraktuar nga Agjencia). Ky auditim është kryer si kusht i marrëveshjes për grant ndërmjet ZNKE-së dhe Agjencisë. Raporti i auditimit nuk është paraqitur akoma deri në datën e deklarimit të pasqyrës financiare të Agjencisë për vitin 2009.

Bilanci i detajuar i Llogarive Bankare 2008-2009 është i prezantuar në Shtojcën IV.

Llogarit e detajuara Vjetore të AKP-së për 2008- 2009 janë të prezantuara në Shtojcën V.

Përmbledhje e Informatave për Menaxhmentin është i prezantuar në Shtojcën VI.

### 5.4 Departamenti Ligjor

Departamenti Ligjor i AKP-së ofron informacione të rëndësishme në të gjitha aktivitetet e AKP-së përfshirë privatizimin, likuidimin, prokurimin, rastet gjyqësore, shqyrtimi dhe ndryshimet e shitjet e kontratave, rregulloret e brendshme dhe instrumentet tjera ligjore. Departamenti Ligjor i AKP-së gjithashtu është pikë fokuse dhe njëra prej njësive kyçe për mbështetje ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me Bordin e Drejtorëve të AKP-së.

Në përgjithësi, Departamenti Ligjor në vëllimin e punës më të madhe, përballet me ndërrimin e stafit pasi që shumica e stafit të vjetër kanë braktisur punët e tyre kryesisht duke ju bashkangjitur organizatave të reja ndërkombëtare në Kosovë. Për momentin Departamenti Ligjor i AKP-së është i përbërë nga 42 anëtar të stafit. Rekrutimi i ri i pozitave të lira janë pritur prej fillimit të janar 2010. Ngritja e kuadrove konstante dhe sistematike e stafit brenda Departamentit Ligjor të AKP-së paraqet një objektivë të menjëhershme të Agjencisë.

Përveç kësaj, një gjendje politikës mjaft e pasigurt e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (“DHPGJS”) ndaj Agjencisë Kosovare të Privatizimit paraqet pengesë serioze dhe një sfidë për Departamentin Ligjor të AKP-së. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009, DHPGJS-ja ka lëvizur nga pozita e saj në kuptim pozitiv ndaj subjektivizmit ligjor të AKP-së.

#### Aktivitetet jashtë vendit

Njësia e Çështjeve Gjyqësore ka marrë pjesë në disa lëndë në gjykata të cilat janë në proces jashtë Kosovës. Bazuar në të dhënat që posedon Agjencisë, në përgjithësi janë 8 lëndë të gjykatës të cilat janë në proces në gjykata të ndryshme në Malin e Zi. Anëtarët e stafit të Njesisë Ligjore kanë marrë pjesë në disa prej këtyre lëndëve, dhe kanë ndërmarrë veprime të caktuara ligjore. Në ndërkohë, Agjencia ka angazhuar kompani ligjore të jashtme e cila aktualisht është duke trajtuar këto lëndë.

#### 5.4.1 Sekretariati i Bordit të Drejtorëve të AKP-së

Zyra e Sekretariatit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit mbështet të gjitha Departamentet e AKP-së në përgatitjet subjektet dhe materialin e saj për miratim, organizon takimet e BD-së, përkatësisht dymbëdhjetë prej tyre gjatë vitit kalendarik, duke mos përfshirë të jashtëzakonshmet. Sekretariati i Bordit të Drejtorëve të AKP-së i kryesuar nga Drejtori i Sekretariatit Ekzekutiv të Bordit emëruar nga ZCN-ja dhe dy anëtar të stafit të AKP-së.

#### 5.4.2 Njësia e Ankesave

Njësia e Ankesave (NJA) përbëhet prej tetë anëtarëve të stafit, dy prej tyre shërbejnë në Zyrën e Ankesave në Mitrovicë.

NJA ka regjistruar mbi 2455 ankesa të reja gjatë vitit 2009, gjithashtu tri deri në katër herë më shumë dokumente të paraqitura në NJA janë regjistruar si parashtrës shtesë të cilat nuk llogariten në llogaritje elektronike të numrit total të ankesave.

Të gjitha ankesat e parashtruara nga ankuesit, nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DHPGJS) dhe gjykatat tjera vendore janë regjistruar siç duhet, janë ruajtur në mënyrë elektronike dhe janë procesuar.

Nga totali i 2455 ankesave të pranuar nga ankuesit dhe Gjykatat e rregullta, gjatë vitit 2009, rreth 1700 dokumente të gjykatës janë parashtruar në AKP nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DHPGJS).

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

### 5.4.3 Komisioni për shqyrtimin e listave të punëtorëve

Komisioni për shqyrtimin e listave të punëtorëve gjatë periudhës 2009 ka arritur të realizoj objektivat e saja kryesore siç janë paraparë. Të gjitha ankesat e NSH-së janë shqyrtuar të cilat janë publikuar gjatë aktiviteteve të Agjencisë paraardhëse, përkatësisht ndërmarrjeve që janë publikuar në vitin 2007.

Lista e shtatë (7) NSH-ve që është përfunduar shpërndarja e 20%

NSH	Rajoni	Shuma e shpërndarë	Numri i punëtorëve
1. Eximkos	Prishtinë	€ 605,156.20	110
2. IMN Dukagjini-Gjakovë	Pejë	€ 1,216,899.39	227
3. NHTT Rugova	Pejë	€ 526,115.44	157
4. Fabrika e Plastikës-Skenderaj	Mitrovicë	€ 185,335.61	142
5. Stacioni i Veterinarisë Prizren	Prizren	€ 32,573.39	5
6. FAN-Podujevë	Prishtinë	€ 496,765.43	420
7. Kosova Kontroll	Prishtinë	€ 17,476.67	6

### 5.4.4 Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Likuidim (KSHAL)

- (i) Rishikon dhe vendos për ankesat e parashtruara kundër vendimit të lëshuar nga Komisionet e Likuidimit.
- (ii) Përgatit dhe shpërndan vendimet e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në Likuidim.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009 anëtari ndërkombëtar i KSHAL-së është emëruar nga PCN/PSBE-së. Veç kësaj, anëtari i sipërpërmendur gjithashtu shërben si kryesues i KSHAL-së. Anëtari tjetër i KSHAL-së gjithashtu është i rekrutuar gjatë vitit 2009. Për shkak të faktit të ditur lidhur me shtyrjet e përgjithshme të procesit të likuidimit, KSHAL-ja është angazhuar shumë në përgatitjen e punës përfshirë rolin aktiv në hartimin e sërishëm të udhëzuesit për likuidim dhe shablloneve të likuidimit. Veç kësaj stafi i KSHAL-së është përfshirë në mënyrë aktive në kurset e ngritjes së kuadrove në stafin e likuidimit të organizuar nga AKP-ja dhe në bazë ad-hoc stafi është angazhuar në detyrat tjera kryesisht në shqyrtimin e kontratave të shitjes dhe çështjet specifike gjyqësore.

Aktualisht komisioni është pajisur me vulat e duhura të cilat do të përdoren për protokoll (log) dhe certifikimi i vendimeve.

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

### 5.5 Departamenti i Burimeve Njerëzore

Funksioni i Departamentit të Burimeve Njerëzore është funksionimi i menaxhmentit dhe shërbimeve, duke i ndryshuar prioritetet strategjike dhe operacionale të Agjencisë. Departamenti Burimeve Njerëzore ka kontribuar duke ofruar udhëheqje profesionale në implementimin dhe operimin e sistemeve dhe praktikave efektive të Burimeve njerëzore. Këto përfshijnë planifikimin e stafit, rekrutimin, politikën e pagave, analizat e nevojave të trajnimit dhe paraqitja e aktiviteteve të duhura për trajnim, zgjedhjen e konflikteve, këshillimin e stafit dhe kontributin e zhvillimit të drejtë dhe proceseve administrative efektive. Drejtori i Burimeve Njerëzore i raporton dhe punën në mënyrë interaktive me menaxhmentin e Agjencisë në pajtim me politikën e stafit dhe të punësimit të Agjencisë miratuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së, dhe menaxhon një grup kompakt të Zyrtarit të Burimeve Njerëzore. Departamentit të Burimeve Njerëzore punon në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Financave dhe Buxhetit.

#### Gjendja aktuale dhjetor 2009

##### ZNKE

		GJENDJA			GJITHSEJT
		I PLOTËSUAR	NË PROCES	I LIRE	
DEPARTAMENTI I GJËRË	Departamenti	VENDOR	VENDOR	VENDOR	
DEPARTAMENTI LIGJOR	Sekretariati Ligjor	4	1		5
	Njësi për Regjistrimin e Ankesave	7			7
	Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Likuidim (KSHAL)	3	2		5
	Komisioni për Shqyrtimin e Listave të Punëtorëve (KSHLP)	8	1		9
	Njësia për Regjistrimin e Ankesave, Mitrovica veriore	2			2
	Shërbimet Ligjore-çështjet gjyqësore	9			9
	Shërbimet Ligjore-KPS	3			3
	Shërbimet Ligjore-Mendimet	3	1		4
	Shërbimet Ligjore-Kontratrat	3			3
<b>GJITHSEJT</b>		<b>42</b>	<b>5</b>		<b>47</b>
NJËSIA PËR AUDITIM TË BRENDSHËM	Njësia për Auditim të Brendshëm	4			4
<b>GJITHSEJT</b>		<b>4</b>			<b>4</b>
DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT	Departamenti i Financave dhe Buxhetit	11			11
<b>GJITHSEJT</b>		<b>11</b>			<b>11</b>
DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE	Departamenti i Burimeve Njerëzore	5			5
<b>GJITHSEJT</b>		<b>5</b>			<b>5</b>
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	Njësi a Prokurimit	4			4

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

		GJENDJA			
		I PLOTËSUAR	NË PROCES	I LIRE	<i>GJITHSEJT</i>
DEPARTAMENTI I GJËRË	Departamenti	VENDOR	VENDOR	VENDOR	
	Njësi e TI-së dhe Komunikimit	5			5
	Njësia e Arkivës	3			3
	Njësia e Përktimi	10			10
	Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme	8			8
	Zyra Ballore	1		1	2
<b>GJITHSEJT</b>		<b>31</b>		<b>1</b>	<b>32</b>
<b>DIVIZIONI PËR QEVERISJE KORPORATIVE</b>					
	Njësia e Administrimit Direkt	5			5
	Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes	3			3
	Njësia e Monitorimit	4			4
	Zyra Ballore Ekzekutive	3			3
	Njësia e Trepçës		1		1
<b>GJITHSEJT</b>		<b>15</b>	<b>1</b>		<b>16</b>
<b>DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL</b>					
	Zyra Ballore	2			2
	Zyra Rajonale në Prishtinë	20	1		21
	Zyra Rajonale në Gjiilan	15	1		16
	Zyra Rajonale në Pejë	18			18
	Zyra Rajonale në Mitrovicë	18			18
	Zyra Rajonale në Prizren	17			17
<b>GJITHSEJT</b>		<b>90</b>	<b>2</b>		<b>92</b>
<b>DIVIZIONI PËR REALIZIMIN E ASETIVE</b>					
	Zyra Ballore e Ekzekutivit	3			3
<b>GJITHSEJT</b>		<b>3</b>			<b>3</b>
<b>DEPARTAMENTI I SHITJES</b>					
	Departamenti i Shitjes	4			4
	Njësia për Përgatitjen e Tenderit	2			2
	Njësia për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitor	6			6
	Njësia për Bujqësi dhe Pylltari	8			8
	Njësia për Kadastër	4			4
<b>GJITHSEJT</b>		<b>24</b>			<b>24</b>
<b>DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT</b>					
	Departamenti i Likuidimit	3			3
	Njësia e Likuidimit	1			1
	Njësia për Mbylljen e Tenderit	5			5
	Njësia për Tranzicion	2			2
	Njësi për Lista të Punëtorëve	3			3

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

		GJENDJA			
		I PLOTËSUAR	NË PROCES	I LIRE	<i>GJITHSEJT</i>
<b>DEPARTAMENTI I GJËRË</b>	<b>Departamenti</b>	<b>VENDOR</b>	<b>VENDOR</b>	<b>VENDOR</b>	
<b>GJITHSEJT</b>		<b>14</b>			<b>14</b>
<b>DEGA EKZEKUTIVE E DREJTORIT MENAXHUES</b>	Njësia për Shtyp dhe Marrëdhënie me Publikun	1	1		2
	Zyra Ballore e Ekzekutivit	1		1	2
<b>GJITHSEJT</b>		<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>4</b>
<b>GJITHSEJT</b>		<b>241</b>	<b>9</b>	<b>2</b>	<b>252</b>

## 5.6 Departamenti i Administratës

### Buxheti

Në periudhën raportuese që mbaron më 31 dhjetor 2009, Departamenti i Administratës ka pasur 1,568,685.00€ të ndara për buxhetin e tij.

Jashtë kësaj, Departamenti i Administratës ka arritur të shpenzoj rreth 71.70% të kësaj shume të buxhetit të alokuar për vitin 2009.

Është e rëndësishme të përmendet, që prej këtij buxheti, 2 linja buxhetore nuk janë iniciuar. Njëra prej këtyre linjave, zhvillimi i softuerit të administrimit financiar ka qenë projekt kapital, ka pasur një alokim të fondeve në shumë prej 65,000.00 €, ndërsa projektet tjera janë për Sigurimin e Detyrimeve në shumë prej 120,000.00 €.

Këto dy projekte janë alokuar në buxhetin e vitit 2010.

### Politikat dhe procedurat

Gjatë vitit 2009, Departamenti i Administratës ka përgatitur dhe pranuar miratimin e menaxhmentit për politikat dhe procedurat e brendshme si në vijim:

- Procedurat për regjistrimin e aseteve, kontrollit dhe raportimit;
- Ligji mbi Sigurinë në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës
- Rregullorja për Mbrojtje nga Zjarri;
- Politika e Prokurimit;
- Politikat e Përfaqësimit në bashkëpunim me Departamentin e Financave dhe Buxhetit;
- Rregullorja mbi themelimin dhe operimin e Komisionit për prona;
- Rezoluta për pirje të duhanit;

### Menaxhimi i aseteve të AKP-së

Departamenti i Administratës aktualisht është në proces të regjistrimit të aseteve të saja për vitin që mbaroj 2009. Komisionet janë themeluar në Zyrat Qendrore dhe zyrat rajonale dhe ata aktualisht janë në proces të regjistrimit të të gjitha aseteve të AKP-së. Raporti përfundimtar mbi statusin e aseteve të AKP-së do të dërgohet pas 18 janarit të vitit 2010.

### Aktivitete tjera të rëndësishme

- Për të ofruar më shumë hapësirë të mjaftueshme për zyre, janë blerë kontejnerë të rinj për të vendosur për numrin në rritje të stafit të AKP-së;
- Janë themeluar 3 zyre të reja përkrahëse në Shtërpcë, Graçanicë dhe Lepsaviç;
- Për të ofruar mjedis më të mirë të punës, të gjitha tepisonat janë shtruar në AKP;
- Është blerë softueri për arkiv dhe është në proces të testimit nga Njësia e Arkivës;
- Të gjitha dokumentet e Ndërmarrjeve Publike që duhet të largohen nga AKP-ja dhe të dërgohen në Ministria të Financave dhe Buxhetit janë identifikuar.



### Konkludim

AKP-ja fuqimisht beson që ka kryer punët mirë Në bazë të rrethanave dhe për të rritur performansën dhe vazhduar me operimet e qeta, ekziston një nevojë urgjente lidhur me ndryshimet në legjislacionin aktual lidhur me aktivitetet e AKP-së dhe Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe pajtueshmërisë së plotë me dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Status të Presidentit Ahtisari.

Këto ndryshime të domosdoshme në legjislacionin aktual janë kërkuar për të mundësuar funksionim të duhur të AKP-së dhe DHPGJS-së në Kosovë e cila padyshim do të shpejtojë tërë procesin e privatizimit dhe në veçanti të likuidimit dhe shpërndarjes së 20% për punëtorët e kualifikueshëm duke lejuar AKP-së të përmbush mandatin e saj brenda afatit kohor të caktuar.

Në fund, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE) në Kosovë për mbështetjen financiare.

Bordi i Drejtorëve,

Dino Asanaj,

Kryesuesi

## Shtojcat

## **Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009**

### **Shtojcë I – Libri Amzë Informativ për Kompanitë nën Administrim Direkt**

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

### GIJENDJA E NDËRMARRJEVE NËN ADMINISTRIM DIREKT PËR PERIUDHËN 01 Janar – 31 Dhjetor 2009

Nr. i NSH-së	Emri i Ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit Direkt	Vështirësitë e Ndërmarrjes Shoqërore	Çështjet e Menaxhmentit dhe Qeverisjes së Korporatave	Perspektiva e të ardhmes
1.	<p><b>NSH “EMIN DURAKU”</b></p> <p><b>09/04/2008</b> <b><i>BAZUAR NË <u>AR1391</u></i></b></p> <p>Bazuar në gjendjen financiare të 31 dhjetorit 2009</p> <p>Të hyrat: 22.993 € Të hyrat nga grantet qeveritare: 2.882 € Shpenzimet: 16.524 € Paratë e gatshme: 1.677€</p>	<p>-Ndërmarrja Shoqërore “Emin Duraku” është deklaruar të jetë shoqëri aksionare.</p> <p>- Rimëkëmbja e vështirë pas shkarkimit të Menaxhmentit të mëparshëm që ishte kapur duke shitur pajisjet e prodhimet si mbeturina</p> <p>-Vështirësitë për të mbledhur të hollat e qirasë.</p>	<p>-Situata në NSH “Emin Duraku” është nën, pas ndërhyrjes së punonjësve të sigurimit nga kompania e Sigurimit të Delta, kontraktuesi i AKP-së. Të drejtën e hyrjes në lokalet e Drejtorisë së Administratës ka vetëm Menaxhmenti e ndërmarrjes "Emin Duraku" i përbërë nga 5 persona dhe udhëheqja e Unionit të Punëtorëve e përbërë nga tre persona.</p> <p>- Regjistrimin e asetve të Ndërmarrjes është kryer dhe llogaritë bankare të ndërmarrjes janë vënë nën kontroll.</p> <p>- Jemi duke punuar në përcaktimin e statusit të ndërmarrjes</p> <p>- Mbledhja e qirasë është përmirësuar gjithnjë e më shumë dhe nga ajo rregullisht është paguar Menaxhmenti dhe kohë pas kohe edhe punonjësit me ndihmë sociale.</p>	<p>- Duhet të punohet që statusi i ndërmarrjes të përcaktohet sa më shpejt të jetë e mundur. Pas kësaj ajo mund të ecë me hapa më të shpejtë pasi Ndërmarrja nuk do të ketë më çështje të pazgjidhura ligjore apo pronësore.</p>
2.	<p><b>NSH “VIRXHINIA”</b></p> <p><b>09/04/2008</b> <b><i>BAZUAR NË <u>AR1367</u></i></b></p> <p>Bazuar në gjendjen financiare të 31 dhjetorit 2009</p> <p>Të hyrat: 55.201 € Shpenzimet: 53.062 € Paratë e gatshme: 83 €</p>	<p>- Kjo ndërmarrje është propozuar për privatizim në Valën e 27, por pas refuzimit të Menaxhmentit dhe punëtorëve për bashkëpunim është tërhequr.</p> <p>- Ankesat e punëtorëve bazohen në atë se kjo është shoqëri aksionare</p> <p>Ndërmarrja ka parashtruar ankesë në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme kundër AKP-së për shkak të mos mbrojtjes së statusit</p>	<p>-Është arritur një bashkëpunim adekuat në këtë ndërmarrje gjatë këtij viti dhe tani ata i raportojnë Administratës</p> <p>-Llogaria bankare e Ndërmarrjes po ashtu mbikëqyret nga ana e Administratës Direkt..</p> <p>- Kjo Ndërmarrje është aktive dhe gjeneron të hyra nga qiraja. Pajisjet e Ndërmarrjes mirëmbahen shumë mirë.</p> <p>-Ndërmarrja gjithashtu paguan të gjitha obligimet e veta.</p>	<p>-Është propozuar që gjatë vitit 2010 të kaloj nga Administrimi Direkt e të kthehet nën juridiksion të Agrikulturës aty ku ka qenë më parë.</p>

## Agjencia Kosovare e Privatizimit - Raport Vjetor 2009

Nr. i NSH-së	Emri i Ndërmarrjes dhe mandati i Administrimit Direkt	Vështirësitë e Ndërmarrjes Shoqërore	Çështjet e Menaxhmentit dhe Qeverisjes së Korporatave	Perspektiva e të ardhmes
		të saj.		
